Save the Children

ALMA MATER STUDIORUM
UNIVERSITÀ DI BOLOGNA
DIPARTIMENTO DI SCIENZE DELL'EDUCAZIONE
"GIOVANNI MARIA BERTIN"

Analiza e situatës mbi zhvillimin dhe kujdesin gjatë fëmijërisë së hershme

PASQYRIMI I PROFESIONALIZMIT TË EDUKATORËVE, PRITSHMËRITË E PRINDËRVE, PËRFSHIRJA E FËMIJËVE TË MINORITETEVE ETNIKE DHE ME NEVOJA TË VEÇANTA.

Analiza e situatës mbi zhvillimin dhe kujdesin gjatë fëmijërisë së hershme

PASQYRIMI I PROFESIONALIZMIT TË EDUKATORËVE, PRITSHMËRITË E PRINDËRVE, PËRFSHIRJA E FËMIJËVE TË MINORITETEVE ETNIKE DHE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Autorët:
Prof. Francesca Emiliani, Profesoreshë e Rregullt në Departamentin e Psikologjisë Sociale
Lucia Balduzzi, PhD Hulumtuese e Lartë në Edukim
Dr. Giannino Melotti, PhD Hulumtues i Lartë në Psikologji Sociale
Prof. Dr. Paola Villano, PhD Profesoreshë e Asocuar në Psikologji Sociale

Studimi i Mbështetur nga:
Save the Children
Programi për Zhvillim dhe Kualitet
Rudina Ademi Shala
Linda Hoxha

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina:"
Prof. asc. Dr. Zeqir Veselaj
MA. Arlinda Beka, Phd. c.

Përkthimi dhe Korrektimi
A&B Associates

Dizajni, Faqosja dhe Shtypi
Envion

Botuar Nga:
Save the Children
Gazmend Zajmi, nr. 01
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 23 26 91
FAX: +381 (0) 38 23 26 93
scik@savethechildren.org
http://Kosovo.savethechildren.net

© Prill 2014 Save The Children

Të gjitha të drejtat i përkasin save the chilren, zyrës në Kosovë. ai mund të riprodhohet me çdo metodë, pa pagesë apo leje paraprake për qëllime mësimore, por jo për rishitje. për përdorim në çfarëdo rrethane tjetër, leja paraprake me shkrim duhet te merret nga botuesi.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë mendimet e save the children

GRUPI KËRKIMOR

Francesca Emiliani, Lucia Balduzzi, Giannino Melotti, Paola Villano

PARATHËNIE

Programet e Save the Children mbi fëmijërinë e hershme bazohen në të kuptuarit e përgjithshëm të fëmijës, duke i kombinuar nevojat zhvillimore, kognitive, fizike, socio-emocionale dhe gjuhësore. Kujdesi dhe zhvillimi gjatë fëmijërisë së hershme siguron që fëmijët të mbijetojnë, të zhvillohen dhe ta arrijnë potencialin e tyre.

Save the Children në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin e Bolonjës, ka zbatuar projekin hulumtues për Analizën e Situatës mbi Zhvillimin dhe Kujdesin gjatë Fëmijërisë së Hershme në Kosovë, duke përfshirë 5 komuna: Prishtinën, Prizrenin, Mitrovicën, Gjilanin dhe Pejën.

Rezultatet e dala nga Analiza e Situatës për Zhvillimin dhe Kujdesin gjatë Fëmijërisë së Hershme tregojnë se është e domosdoshme t'i kushtohet rëndësi ngritjes së vetëdijes mbi zhvillimin dhe kujdesin gjatë fëmijërisë së hershme, trajnimin dhe ngritjen profesionale të edukatoreve, krijimin e mundësive për vijimin e shërbimeve edukative dhe të kujdesit për fëmijët e komunitetit RAE dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Njëkohësisht, rekomandohet që të ketë shërbime publike të integruara për fëmijët dhe familjet e tyre. Edhe pse fokusi i projektit hulumtues është në 5 komuna, në të cilat punon Save the Children, me këto rezultate synohet të influencohen edhe akterë në nivelin lokal dhe kombëtar.

Mbështetja e Save the Children për kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme konsiston në ofrimin e ndihmës themelore, e cila i nevojitet fëmijës për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar në jetë, si dhe në përkrajen e familjeve dhe komunitetit që ta promovojnë zhvillimin e shëndëtshëm dhe rritjen e fëmijës. Trajnimet profesionale për zhvillim e fëmijërisë së hershme ndihmojnë dhe përmirësojnë jetën e fëmijëve dhe kualitetin e edukimit që ata e marrin.

Programet e kujdesit dhe zhvillimit gjatë fëmijërisë së hershme përgatisin fëmijët për shkollë dhe zvogëlojnë efektet e varfërisë, duke siguruar një fillim të barabartë për të gjithë fëmijët dhe duke përmirësuar rezultatet e të mësuarit në të ardhmen. Programet tona u ndihmojnë fëmijëve, që në mënyrë efektive t'i zgjidhin problemet, si dhe t'i ndërtojnë aftësitë e "transferueshme", të cilat u nevojiten në shkollë dhe më gjerë.

Falënderojmë përzemërsisht të gjithë prindërit e fëmijëve dhe edukatoret që morën pjesë në këtë hulumtim. Save the Children, së bashku me institucionet vendore do të punojë në mënyrë aktive, që ta përmirësojë kualitetin dhe qasjen gjithpërfshirëse të fëmijëve në shërbimet për zhvillim dhe kujdes gjatë fëmijërisë së hershme.

Falënderime të veçanta i drejtohen Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Bolonjës për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre profesional gjatë gjithë procesit të hulumtimit.

Ne fuqimisht besojmë se ky hulumtim do të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes dhe rëndësinë mbi investimin për kujdesin dhe zhvillimin gjatë fëmijërisë së hershme.

Ahmet Kryeziu
Drejtor Vendor

Falënderime:

Dëshirojmë t'i falënderojmë të gjithë ata që na ndihmuan, na ofruan mbështetje dhe na orientuan drejt arritjes së rezultatit final. Falënderojmë znj. Labëri Luzha, zyrtare për arsimin parashkollor në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Tekonologjisë; znj. Afërdita Spahiu specialiste për edukim në UNICEF; të gjitha kopshtet publike dhe private në Prishtinë, Prizren, Gjilan, Pejë, dhe

Mitrovicë, që ishin pjesëmarrëse në hulumtim.

Gjithashtu, falënderojmë studentët e Fakultetit të Edukimit për mbledhjen e të dhënave dhe transkripimin e fokus grupeve: Dafina Ramaj, Valdete Jahaj, Mrika Kllokoqi, Fitore Murati, Anila Reqica, Vjollca Qorri, Armend Tërshana, Liridon Mulliqi, Violeta Peci dhe Albana Ahmeti. Një falënderim i veçantë i dedikohet profesorëve të Universitetit të Prishtinës, z. Zeqir Veselaj dhe znj. Arlinda Beka.

Falënderim i veçantë për Save the Children, Italinë dhe ekipin që e ka mbështetur këtë hulumtim Chiara Segrado, Mari Luz La Rosa dhe Elisabetta Mina.

Po ashtu, falënderojmë eksperten e Zhvillimit dhe Kujdesit të Fëmijërisë së Hershme, Jill Mcfarren Aviles për ndihmën e ofruar, për zhvillimin e këtij projekti.

Në fund, dëshirojmë ta falënderojmë stafin e Save the Children, znj. Rudina Ademi – Shala menaxhere e Programit për Zhvillim dhe Kualitet dhe znj. Linda Hoxha zyrtare për Monitorim dhe Vlerësim, për ofrimin e ekspertizës së tyre gjatë tërë procesit.

Save the Children

Fjalorth/Shkurtesa

EKFH - Edukimi dhe Kujdesi në Fëmijërinë e Hershme.

ESPri - Rezultatet nga Institucionet Parashkollore Private.

ESPub - Rezultatet nga Institucionet Parashkollore Publike.

Institucion parashkollor - Është term që përdoret në përgjithësi për institucionet që frekuentohen prej fëmijëve nga mosha 0 – 6 vjeç.

IP - Institucion Parashkollor.

Kopsht - Janë të gjitha klasat, të cilat frekuentohen nga fëmijët prej 3 – 5 vjeç.

Parafillor - Frekuentohet nga fëmijët prej 5 -6 vjeç.

RAE - Shkurtesë për Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje
2. Disa reflektime lidhur me kornizën ligjore
3. Hipotezat e kërkimit dhe zgjedhjet metodologjike
4. Edukatoret e kopshtit – karakteristikat profesionale
5. Prindërit e fëmijëve që frekuentojnë kopshtet– karakteristikat dhe përmbushjet lidhur me institucionin parashkollor
6. Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijëve të komunitetit RAE – fjalët e prindërve të tyre
7. Rekomandimet përfundimtare
8. Referencat

I. HYRJE

Që nga viti 2000, në disa shkresa, ka pasur përpjekje për ta përshkruar dhe analizuar gjendjen në sistemin arsimor në Kosovë, për t'i shoqëruar reformat strukturore, që kanë ndikuar në këtë zonë (UNICEF 2011, USAID 2012, OECD 2003) dhe, në mënyrë më të përgjithshme, në të gjithë vendin.

Debati, hulumtimet dhe mbi të gjitha, veprimet politike dhe dispozitat inovative të bashkërenduara gjatë këtyre dhjetë vjetëve të fundit, për të ndërhyrë në sistemin parashkollor dhe shkollor, janë fokusuar në fushat, ku gjendja kritike ka qenë më urgjente e pasluftës: për t'i rindërtuar objektet dhe për t'i mbushur ato me nxënës, veçanërisht në edukimin e obliguar dhe atë të mesëm. Përpjekjet janë shtrirë edhe në sektorin parashkollor, i vlerësuar si kryesor për zhvillimin e një sistemi, në të cilin realizohen plotësisht të drejtat e qytetarisë dhe pjesëmarrjes së të gjithë popullsisë, për një edukim në demokraci, tolerancë dhe paqe.

Ndaj, Qeveria e Kosovës ka siguruar përgatitjen e një reforme të plotë të sistemit të arsimit kombëtar, duke ndërtuar një linjë të vetme që fillon nga edukimi parashkollor, për të vazhduar me edukimin universitar, që është pika e referencës për zbatimin e plan-programit, kurrikulës për renditjen dhe nivelet arsimore, dhe të ndryshuara më pas si rezultat i reformës. Me gjithë përpjekjet e mëdha, të bëra nga Qeveria e Kosovës dhe nga ana e OJQ-ve dhe shoqatave, që punojnë në pozita të ndryshme në zona të caktuara, ka ende shumë çështje kritike që ekzistojnë në sektorin e arsimit dhe në veçanti, paraqitet si shumë problematike, qasja në sistemin edukativ të fëmijëve të moshës nga 0 deri 5 vjeç, dhe në mesin e tyre, ata me një prapavijë të pafavorshme, që lidhet me aftësinë e kufizuar ose përkatësinë e grupeve minoritare etnike, si për shembull në komunitetet RAE.

Tashmë, dihet se edukatoret janë faktori kryesor për ndryshimin dhe risinë në institucionin parashkollor, si edhe suksesi i çdo reforme brenda institucionit (NESSE, 2008; CORE, 2011). Dihet gjithashtu edhe se pjesëmarrja e familjeve dhe paraqitja e nevojave të tyre, është po aq e nevojshme për t'u mbështetur nga jashtë proceset e renovimit dhe reformës në arsim. Fokusi i hulumtimit për këtë arsye, ka pasur për qëllim kryesisht edukatoret dhe prindërit për të mbledhur perceptimet dhe përvojat e tyre në lidhje me aspektet qendrore të profesionalizmit në fushën e arsimit dhe pritshmërinë për qasje në shërbime dhe në institucionin parashkollor.

Në veçanti, ky raport ka për qëllim ta pasqyrojë dhe t'i zbulojë dy dimensione specifike të hulumtimit në fushën e edukimit parashkollor:

- Analizën e statusit profesional të edukatoreve (mostra) dhe mësuesve të angazhaur.
- Vëmendjen ndaj temës së qasjes në sistemin parashkollor, duke iu referuar në mënyrë të veçantë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre të komuniteteve RAE.

Qëllimi final i studimit është ta mundësojë hartimin e rekomandimeve dhe përcjelljen e tyre te përfaqësuesit politikë lokalë dhe përfaqësuesit e OJQ-ve, në mënyrë që të realizohen me kohë dhe në mënyrë efektive ndërhyrjet si në nivel të politikave, ashtu edhe në nivel të veprimeve.

Studimi është kryer në 3 faza:

Faza e parë konsiston në analizën sistematike të dokumenteve, që kanë të bëjnë me politikat dhe programet për fëmijërinë e hershme. Objektivi i kësaj faze ka qenë të kuptohet korniza referuese, brenda të cilit ndodhet sistemi edukativ për fëmijërinë e hershme, të paktën në aspektin e deklaratave të qarta. Dokumentet e shqyrtuara përfshijnë rregullat, strategjitë, programet, kurrikulat dhe analiza të veçanta të kryera në fushën e edukimit në sistemin parashkollor.

Faza e dytë përbëhet nga vizita të shkurtra në terren, nëpërmjet intervistave me përfaqësues të zgjedhur (drejtuesve të shkollave, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues politikë dhe akademikë universitarë,

ekspertë të kësaj fushe) dhe vizitave në institucionet parashkollore dhe në një spital: vizita në institucionin parashkollor publike "Gëzimi Ynë" në Prishtinë, në institucionin parashkollor private "Bardha" dhe intervista me drejtoreshën e këtij institucioni znj. Gëzime Rexhepi në Prishtinë, duke vazhduar me vizitën në institucionin parashkollor publik "Pëllumbat e Paqes" në Pejë, si dhe intervista me Dr. Shemsije Dukaj dhe vizita në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Pejë. Objektivi i kësaj faze ishte thellimi i informacionit të mbledhur përmes vlerësimit, plotësimit të vendeve të zbrazëta të informatave, zgjidhjes së ndonjë paqartësie ose moskuptimi.

Faza e tretë konsiston në realizimin e një studimi në terren drejtuar edukatoreve dhe prindërve të të gjitha institucioneve parashkollore të 5 qyteteve mostër, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren, dhe në ndërtimin e 7 grupeve të fokusit me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe etni rome, ashkalie dhe egjiptase.

Pyetësorët dhe pyetjet hulumtuese janë diskutuar me ekipin referues të 'Save the Children' dhe janë përkthyer në gjuhën shqipe.

DISA REFLEKTIME LIDHUR ME KORNIZËN LIGJORE

Përgjegjësia për shkollat publike (institucionet parashkollore, fillore, shkollat e mesme të ulëta dhe të larta dhe arsimi i lartë) është e Ministrisë së Arsimit (MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës). MASHT është përgjegjëse për planifikimin, mbështetjen, koordinimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve arsimore në nivel të përgjithshëm, ndërsa mbështetja për funksionimin e shkollave është përgjegjësi e nivelit komunal.

Qeveria, në nivel qendror, jep referenca specifike, veçanërisht lidhur me çështjet e shëndetit publik dhe sigurisë, të nevojshme për hapjen dhe funksionalizimin e institucioneve arsimore për fëmijërinë e hershme dhe të vonshme. Legjislacioni i jep komunës përcaktimin për kuotën e pjesëmarrjes së familjeve në institucionet parashkollore.

Legjislacioni kryesor referues për themelimin dhe funksionimin e institucioneve parashkollore është fare i ri: Ligji daton që nga janari 2006 (L.N. 02/L-52). Ne besojmë se rregulloret, edhe pse në mënyrë implicite dhe të paskicuara, shprehin një projekt me një qasje pedagogjike dhe janë të një rëndësie të veçantë për t'u fokusuar në nenet e para të Ligjit, për të provuar që të shpjegohet struktura pedagogjike e dokumentit.

Në përputhje me vlerat e shprehura në Kushtetutë, parimet bazë të Ligjit janë kryesisht ato të barazisë, përfshirjes, demokracisë (neni 4). Sa për nenin 24 të Kushtetutës së Kosovës, ku nuk është dhënë ose cituar në mënyrë eksplicite, neni 6 i Ligjit Nr. 02/L-52 pohon të drejtën për arsimim për të gjithë fëmijët, duke përfshirë edhe ata me "nevoja të veçanta":

"6.1. Edukimi parashkollor është e drejtë e të gjithë fëmijëve përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta, i cili do të realizohet në përputhje me këtë Ligj dhe me akte nënligjore ". [1]

Këto të dhëna, së bashku me thirrjet e përsëritura të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, vendosin të drejtën e shkollimit ndërmjet të drejtave themelore të të gjithë fëmijëve dhe në veçanti e pranojnë fëmijërinë si një kategori për të cilën janë caktuar të drejta të veçanta dhe origjinale. Në lidhje me parimet e edukimit parashkollor dhe objektivat e rregullores së përcaktuara në nenin 3, edukimi është një e drejtë kyçe, jo vetëm për të siguruar zhvillimin e plotë të njeriut, por edhe për ta siguruar statusin e qytetarit, që nga momentet e para të jetës.

Kësaj të drejte i përgjigjet një sistem unik arsimor/edukativ (neni 2), ku sektori parashkollor është plotësisht pjesë e tij. Parashikimi i një sistemi të unifikuar dhe jo të ndarë, si në vende të tjera, mund të sigurojë koordinimin më të madh nga pikëvështrimi i vazhdimësisë, qoftë organizativ a kurrikular, edhe në prani të një sistemi të përzier të menaxhimit publiko-privat, të parashikuar në nenin 7 dhe të përsëritur në nenin 13, i cili thotë se: "prindërit kanë të drejtën e zgjedhjes së programeve parashkollore për fëmijët e tyre në institucionet publike apo private".

Prindërit marrin pjesë në shpenzimet për mensën në institucionet parashkollore dhe për materialet mësimore; janë parashikuar ulje dhe përjashtime nga pagesa e tarifave për familjet në nevojë.

Elementet e përmendura mund të konsiderohen parime që karakterizojnë, në kuptimin cilësor, vendosjen e standardeve në programin parashkollor në Kosovë, duke i përfshirë autoritetet politike, të përmendura në mënyrë të përsëritur në dokumentet zyrtare edhe ato evropiane, që fokusojnë politikat për fëmijërinë e hershme dhe atë edukative, ku fokusi kryesor është e drejta dhe interesi i fëmijës.

---

1 Neni 24 i Kushtetuës është ai, i cili rregullon barazinë e qytetarëve përballë Ligjit. << Neni. 24-1. Të gjithë janë të barabartë para Ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal >>.-botuar prej 25/02/2010 në adresën http://ëëë.diritto.it/docs/29067-repubblica-del-kosovo-la-costituzione.

Përtej objektivave, Ligji përcakton organizimin dhe përmbajtjen e sistemit parashkollor.

Nëse do ta largojmë vëmendjen nga dimensioni i objektivave te ato të organizimit, prioriteti lëviz nga fëmija te familja.

Neni 8, më poshtë citon:

"Detyrat themelore të institucionit parashkollor janë:

a) mbështetje për prindërit në përkujdesjen e fëmijëve dhe edukimin e tyre;
b) promovimi i cilësisë për fëmijët dhe jetën familjare;
c) krijimi i kushteve për zhvillimin e potencialeve individuale të fëmijëve dhe manifestimi i tyre;
d) krijimi i kushteve për rritjen e aftësive të fëmijëve në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të paraqitura nga shkolla".

Neni 8 pjesërisht duket se i kapërcen prioritetet e shprehura në nenet e para të Ligjit: nga prioriteti i fëmijës kalohet te familja. Në fakt, krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin e potencialit individual të fëmijës dhe manifestimit të tij është vendosur si qëllim i tretë, paraprirë nga mbështetja e familjeve dhe promovimi i cilësisë së jetës së fëmijëve dhe familjeve të tyre. Së fundi, pika d) tregon natyrën përgatitore të sistemit parashkollor në lidhje me kërkesat e edukimit të obliguar(sipas Ligjit Nr. 04/L-032 dhe mund të hyjë në fuqi që nga viti 2015-2016).

Kjo pikë e fundit duket se përputhet me indikacionet e dhëna në Kurrikulën e re të Kosovës.

Për institucionet parashkollore sistemet favorizojnë një qasje parapërgatitore dhe objektivat e arsimit/edukimit shpesh i janë adresuar zhvillimit të aftësive bazë instrumentale (leximit, shkrimit dhe bërja e llogarive) dhe sjelljeve shoqërore që iu paraprijnë njohurive dhe, në përgjithësi, kërkesave që do të vijnë për fëmijët në shkollën fillore. Institucionet parashkollore, të cilat kanë një qasje joparapërgatitore kanë tendencë të vendosin në plan të parë projektime, në të cilat vlerësohen njohuritë e lidhura me zbulimin, kërkimin, stimulimin e kuriozitetit të fëmijëve përmes lojës, kreativitetit, punës në grup, eksperimentimit të materialeve, dhe zgjidhjes së problemeve (ISSA, 2010).

Në aspektin e përmbajtjes dhe atë të metodologjisë ka harmoni më të madhe me të dhënat e Kurrikulës së re të Kosovës të cilat, në paragrafin *Synime të përgjithshme të arsimit në Kosovë*, në mënyrë të përsëritur, paraqesin nevojën për këtë grup të dytë të aftësive për formimin e plotë të një qytetari të lirë dhe aktiv:

"Prandaj, një nga synimet kryesore të arsimit në Kosovë duhet të jetë zhvillimi i njohurive, qëndrimeve dhe aftësive të kërkuara në një qytetari demokratike. Kjo do t'u mundësojë të rinjve që të angazhohen plotësisht në çështjet publike, dhe të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në një shoqëri pluraliste dhe demokratike". Dhe përsëri, kurrikula i referohet nevojës për të përgatitur veten për një jetë në një shoqëri të fortë dhe në ndryshim të vazhdueshëm: "Në këtë drejtim, një tjetër qëllim i rëndësishëm i edukimit në Kosovë është që t'i pajisë studentët me njohuri të vlefshme të përditësuara dhe aftësi instrumentale që do t'i ndihmojnë ata të përballen me sfidat e një shoqërie të edukuar/arsimuar, sipas perspektivës së të mësuarit afatgjatë në një botë të ndërvarur".

Në aspektin e organizimit të punës, Ligji siguron një program vjetor të aktiviteteve edukative, të përcaktuara në mënyrë të pavarur në çdo institucion, duke marrë parasysh edhe punën me fëmijët dhe atë në mbështetje të prindërve.

Një element i mëtejshëm i kualifikimit përfaqësohet nga kualifikimi arsimor i kërkuar nga Rregullorja për rekrutimin e personelit edukativ: kërkohet diploma e shkollës së lartë ose diplomë e shkollës së mesme me specializim për edukatoret dhe diplomë e shkollës së mesme specifike ose e përgjithshme, por me trajnime të veçanta në edukimin parashkollor për pozitën e asistentit. Legjislacioni paraqet një organizim hierarkik të punës, duke parashikuar dhe pozitën drejtuese, gjithashtu duke siguruar udhëheqjen dhe koordinimin e pozitave, si dhe të tjera në lidhje me mbikëqyrjen dhe këshillimin për çështje specifike.

Elemente shtesë, të paqarta, shfaqen në leximin e Kurrikulës së re të Kosovës. Dokumenti përcakton si edukim parashkollor atë për fëmijët 3-6 vjeç (ISCED 0), duke e ndarë këtë periudhë në dy grupe të dallueshme formalisht: kopshti (3-5 vjeç) dhe parashkollorë (5-6 vjeç). Për t'iu përgjigjur renditjes së parashikuar nga Traktati i Lisbonës (2006), (në bazë të Ligjit Nr. 04/L-032 dhe mund të hyjë në fuqi që nga viti 2015-2016) edukimi parashkollor është themeluar si edukim i obliguar, për dallim

nga frekuentimi i parashikuar për çerdhen që është zgjedhore. Organizimi i vitit kalimtar të obliguar (5-6 vjeç) është një çështje që duhet të thellohet më tej. Në fakt, është e mundshme që të radikalizohet perspektiva e frekuentimit të edukimit parashkollor, nisur nga këndvështrimi paraprak, veçanërisht në qoftë se frekuentimi në parashkollor do të jetë me ndërrime, sikurse ndodh në shkollën fillore. Koha e shkurtër në dispozicion, qendërzimi i programit më shumë në përmbajtjen e disiplinave (të dizajnuara edhe në një pikëpamje para disiplinore) se sa te vetë fëmija, numri i lartë i fëmijëve për klasë (dhe për këtë arsye edhe raporti fëmijë /edukatore), janë të gjithë tregues që theksojnë vështirësinë e përputhjes ndërmjet zhvillimit të kompetencave kryesore të përshkruara në hyrje të kurrikulës, me kontekstin dhe organizimin që priren më tepër drejt tradicionales. Në planin e investimeve, gjithashtu, në një sistem ku frekuentimi i nivelit parashkollor është pak i përhapur (vetëm 3% e fëmijëve 0-5 vjeç frekuentojnë institucionet parashkollore), është shumë i pranishëm rreziku që përpjekjet ekonomike dhe organizative të përqendrohen kryesisht (ose ekskluzivisht) në edukimin e obliguar dhe në vitin e obliguar (sipas Ligjit Nr. 04/L-032 që mund të hyjë në fuqi që nga viti 2015-2016) të edukimit parashkollor se sa te zhvillimi, duke mos favorizuar në asnjë mënyrë qasjen në shërbime/institucione edhe as kulturën që mbështet këtë qasje.

Tashmë, në një raport të OECD - së (2003), qasja në institucionet parashkollore konsiderohet si tema kryesore për nivelin edukimit parashkollor; frekuentimi i ulët në këtë kontekst lidhet ngushtë me kulturën e vendit në lidhje me fëmijërinë:

"Qasja në kujdesin parashkollor dhe në edukim në Kosovë është shumë e dobët. Ndryshime të rëndësishme të sjelljes duhet të bëhen në ofrimin e kujdesit nga prindërit, nga komuniteti dhe sistemi i institucionit parashkollor për përmirësimin e kujdesit dhe edukimit në këtë fazë vendimtare në jetën e një fëmije. Shërbimet në fëmijërinë e hershme përdoren shumë pak, dhe shumë pak i jepet rëndësi nevojës për Programe të Zhvillimit të Fëmijës. Regjistrimet janë të ulëta sepse parashkollori nuk është i obligueshëm dhe të kuptuarit e kësaj çështjeje është i dobët, kriteret e regjistrimit janë arbitrare dhe nganjëherë diskriminuese, nuk ka vende në dispozicion, dhe ato janë të kushtueshme" (fq. 349-350).

Raporti, gjithashtu i referohet mungesës së një kurrikule të unifikuar si dhe përgatitjes jo të duhur të edukatoreve, por në këto çështje, ne e dimë se është bërë dhe po bëhet shumë. Rreziku i frekuentimit për një kohë të gjatë në shkallë të ulët në shërbimet për fëmijërinë e hershme është edhe tani shumë i pranishëm dhe kërkon zgjidhje të shpejtë.

Ky hulumtim lind pikërisht për ta mbështetur punën profesionale të pozitës së edukatoreve dhe fokusohet veçanërisht mbi ata që kujdesen për fëmijët në grupmoshën më pak të njohur: atë të fëmijërisë së hershme.

HIPOTEZAT E KËRKIMIT DHE ZGJEDHJET METODOLOGJIKE

Grupi shqyrtues, i cili është cituar në paragrafin e parë, ka nxjerrë në pah disa nga çështjet për të cilat ne e kemi konsideruar të nevojshme për t'u ndalur për një hulumtim më të thellë.

Korniza kulturore, politike dhe institucionale paraqitet të jetë veçanërisht komplekse. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, pasi është miratuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe janë identifikuar format e saj të qeverisjes dhe ushtrimit të demokracisë, shteti gjendet në një situatë, ku prioriteti është i dyfishtë: rindërtimi i vendit, krijimi i institucioneve dhe rregulloreve përmes të cilave t'iu mundësohet qytetarëve të saj t'i gëzojnë të drejtat e tyre themelore.

Të dhënat statistikore japin profilin e një vendi, ku popullsia është ndër më të rejat në Evropë (30% e popullsisë në fakt ka më pak se 15 vjeç dhe vetëm 7% janë mbi 65 vjeç, të dhënat e Anketës Demografike, Sociale dhe të Shëndetit Riprodhues të Kosovës - nr. 2009 cituar nga UNICEF-i, 2011:16); gjatë disa viteve të ardhshme pritet një rritje e konsiderueshme e lindjeve, duke pasur parasysh moshën e re të popullsisë, që korrespondon saktësisht me atë të moshës riprodhuese (UNICEF 2011).

Qeveria shpalli fillimisht Ligjin për Riorganizimin e Sistemit Shkollor (me parashikimin për ta ulur edukimin e obliguar në 5 vjeç (sipas Ligjit Nr. 04/L-032 që mund të hyjë në fuqi, që nga viti 2015-2016) me një vit frekuentim të institucioneve në nivelin parashkollor; vit që është 'hequr' nga periudha e dedikuar kopshtit (aktualisht 0-5 vjeç). Si pasojë redaktohet plani mësimor për nivele të ndryshme edukative. Plan-programi për Kopshtin paraqet një dokument veçanërisht të pasur dhe cilësor; duke u përafruar me dokumente të ngjashme të vendeve evropiane dhe më gjerë, të cilat kanë qasje ndaj edukimit në fëmijërinë e hershme dhe të vonshme me kujdes të madh, aftësi dhe ndjeshmëri.

Analiza e kurrikulës, planprogramit nga njëra anë, dhe të dhënat që kanë të bëjnë me gjendjen e sistemit edukativ, nga ana tjetër (gjendja e objekteve, kualifikimi i ulët i personelit të edukatoreve, jo njëtrajtshmëria në trajnimet dhe kualifikimet e pranuara si të nevojshme për mësimdhënie), ndërlidhur dhe me intervistat dhe vëzhgimet në terren, të kryera nga grupi kërkues, na bëri të pyesim mbi profesionalizmin e edukatoreve, mbi formimin e tyre dhe mbi të gjitha, mbi prezantimin e tyre lidhur me profesionalizmin. Gjithashtu, ekzistonte edhe nevoja për të provuar se sa të hapura ishin edukatoret ndaj trajnimit dhe inovacionit, ndaj zbatimit të programit mësimor, hapja në përfshirjen e të gjithë fëmijëve në hapat e institucionit parashkollor, duke përfshirë ata më në nevojë për shkak të çështjeve kulturore (për shembull: Fëmijët e komuniteteve RAE), ose për shkak se fëmijët me aftësi të kufizuara (me nevoja të veçanta) paraqesin ndryshime të mëdha si në aspektin e praktikës së mësimdhënies dhe në qëndrimet e edukatoreve. Pavarësisht nga hapja e treguar ndaj Ligjit, të dhënat relative të situatës edukative parauniversitare, të përpunuara nga Ministria e Arsimit 2012-13 paraqesin një situatë të largët nga objektivi, duke përfshirë: në kopshte, vetëm 1,6 e fëmijëve i përkasin një etnie të ndryshme, nga ajo shqiptare, dhe vetëm 37 fëmijë në 5389 i përkasin etnisë së komuniteteve RAE; përqindja rritet me pak pikë në edukimin para-fillor: këtu 96.3% të frekuentuesve përbëhet nga fëmijët shqiptarë dhe 3,7% nga grupe të tjera etnike. Për sa i përket gjendjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, situata është edhe më kritike: nuk ka të dhëna për frekuentimin e tyre në kopsht, ndërsa ata janë vetëm 18 në nivelin parashkollor në të gjithë vendin.

Puna kërkimore, e cila është bërë me 'Save the Children', gjithashtu me idenë se të dhënat e mbledhura dhe analizat e tyre pastaj mund të përdoren për t'i drejtuar veprimet e ardhshme për të mbështetur edukimin e fëmijëve 0-6 vjeç, dhe në veçanti ndaj më të vegjëlve, me më pak se tre vjeç. Ideja më e gjerë është ajo e zhvillimit dhe ndërgjegjësimit në botën e edukimit, për një kulturë të fëmijërisë që fokusohet te fëmija, nevojat e tij, por edhe te të drejtat e tij dhe potenciali i tij. Ndaj, për ta mbështetur krijimin dhe zhvillimin e një kulture të tillë, mendimi i prindërve dhe, në përgjithësi, i familjeve të fëmijëve është absolutisht i nevojshëm. Për këtë arsye, dhe ata janë përfshirë si subjekte në hulumtim, për t'i mbledhur opinionet e tyre dhe përvojat e tyre në lidhje me Kopshtin dhe për të nxjerrë në pah dobësitë, veçanërisht te qasja.

Pyetësorët e plotësuar përfaqësojnë tema të rëndësishme dhe komplekse, të cilat janë hulumtuar nga qasje të ndryshme kërkimore, komplementare ndaj njëra-tjetrës. Anketimi, në të cilin janë përfshirë edukatoret është kryer nëpërmjet pyetësorëve sasiorë; për prindërit instrumenti i pyetësorit u plotësua edhe me një kërkim më specifik cilësor të kryer nëpërmjet disa fokus-grupeve.

Në hulumtimin sasior, të orientuar kryesisht për të studiuar variablat specifike, një pyetësor u shpërnda për të gjithë edukatoret në institucionet parashkollore publike të qyteteve, si: Gjilani, Mitrovica, Peja, Prishtina, Prizreni dhe në të njëjtat shkolla u është shpërndarë një pyetësor prindërve të çdo fëmije, djalë apo vajzë, që frekuentonte institucionin parashkollor.

Me pyetësorin drejtuar edukatoreve, dhe atë drejtuar prindërve, ne jemi përpjekur që të nxjerrim në pah aspektet që ndërlidhen me profesionalizmin e edukatoreve që paraqiten si objekt studimi. Të dhënat e marra u analizuan. Janë hulumtuar ndikimet e mundshme reciproke për t'i verifikuar lidhjet kryesore ndërmjet variablave. "Treguesit" që i kanë formuar temat e ndryshme të pyetësorit janë nxjerrë nga analiza teorike e problematikës së hulumtimit; dhe përmes këtyre treguesve kemi lexuar rezultatet e anketës, pa pretenduar të jenë kryer të gjitha. Por, në të njëjtën kohë, me bindjen se pyetjet dhe hipotezat e "treguara" nga secili prej tyre janë të rëndësishme për një njohje më të mirë të problemit nga i cili jemi nisur.

Treguesit e identifikuar për edukatoret janë: arsyet për zgjedhjen e profesionit, pasqyrimi i edukatores ideale, burimet e profesionalizmit, ushtrimi i profesionalizmit, kënaqësia e edukimit, qëllimi i klasave të fëmijëve 0-3 vjeç, marrëdhënia me prindërit.

Treguesit e identifikuar për prindërit janë: arsyet që lidhen me zgjedhjen për të dërguar fëmijën e tyre në institucionin parashkollor; frekuentimi i institucionit parashkollor dhe zhvillimi i fëmijës (ç'përfaqëson funksioni i parashkollorit në zhvillimin e fëmijës?), vlerësimi i hapësirave dhe organizimi i institucionit parashkollor, vlerësimi i marrëdhënieve ndërmjet familjes dhe institucionit parashkollor, kënaqshmëria me personelin e institucionit parashkollor.

Hulumtimi cilësor, i orientuar më shumë për t'u thelluar dhe kuptuar prezantimet e edukatoreve, ka përdorur instrumentin e fokus-grupit si metodologji që mund ta stimulojë, përmes diskutimit dhe dëgjimit reciprok, nxjerrjen e ideve, gjykimeve, opinioneve nga specialistë për temat kryesore të arsimimit të edukatoreve. Qëllimi i këtij momenti të hulumtimit që të gjente një "hapësirë" për të "gjeneruar" interpretime, për të plotësuar dhe kategorizuar supozimet e dala nga rezultatet e pyetësorit.

Pyetësorët

Instrumentet e përdorura për këtë hulumtim sasior janë zhvilluar në muajt tetor-nëntor 2013, nga një ekip kërkimor i përbërë nga Lucia Balduzzi, Francesca Emiliani, Giannino Meleotti, Paola Villano, të cilët kanë përcaktuar strukturën, dhe kanë hartuar pyetjet e anketës. Drafti i parë i pyetësorëve është përkthyer dhe diskutuar nga (Save the Children) që ka kryer redaktimin dhe përkthimin përfundimtar.

Pyetësori i drejtuar edukatoreve

Instrumenti që na rezultoi përbëhet nga një pyetësor i strukturuar që hulumton seksionet e mëposhtme:

- *Të dhëna*t e llojit socio-demografik dhe profesional, si dhe informacionet lidhur me strukturën në të cilën edukatoret bëjnë punën e tyre;
- Motivimet e zgjedhjes profesionale, një listë me 11 arsye, ku subjektet duhet të shënojnë shkallën e rëndësisë së tyre (shkalla nga I=aspak e rëndësishme deri në 4=shumë e rëndësishme);
- Pasqyrimi i edukatorit/es ideal/e, dy grupe të pyetjeve përmes të cilave edukatoreve iu kërkua të tregonin: a) aspektet që bëjnë të mundur identifikimin e një edukatori/eje të mirë (11 pyetje të matura në një shkallë nga 1 = aspak e rëndësishme deri në 4 = shumë e rëndësishme); b) elementët që një edukatore e mirë duhet t'i dijë (13 pyetje të matura me një shkallë nga 1 = aspak e rëndësishme në 4 = shumë e rëndësishme);

- Burimi i Profesionalizmit, dy grupe pyetjesh me qëllimin për nxjerrë në pah: a) nga cilat burime edukatoret deklarojnë se mësojnë për të kryer punën e tyre (9 pyetje të matura me shkallën nga 1=për aspak e rëndësishme në 4=shumë e rëndësishme); b) raporti ndërmjet përvojës profesionale dhe asaj si nënë (4 pyetje të matura me shkallën nga 1=për aspak dakord në 4=shumë dakord);
- Ushtrimi i Profesionalizmit, dy grupe pyetjesh përmes të cilave ishte e rëndësishme të nxirrej në pah: a) rëndësia që i atribuohet objektivave profesionale (11 pyetje të matura me shkallën nga 1=për aspak e rëndësishme në 4=shumë e rëndësishme); b) paraqitja e ndryshimeve ndërmjet fëmijëve, të cilët ndjekin institucionin parashkollor dhe atyre që nuk e ndjekin (12 pyetje të matura me shkallën nga 1=për aspak dakord në 4=shumë dakord);
- Kënaqësia e edukimit, dy grupe pyetjesh nëpërmjet të cilave është matur: a) niveli i kënaqësisë së edukatoreve lidhur me disa elemente, që kanë të bëjnë me profesionin e tyre (14 pyetje matur në një shkallë nga 1 = aspak të kënaqur deri në 4 = shumë të kënaqur), b) niveli i kënaqësisë së subjekteve lidhur me marrëdhëniet e tyre me punonjës të tjerë, në kontekstin e institucionit parashkollor (kolegët, fëmijët, prindërit, etj.) (10 pyetje të matura në një shkallë nga 1 = aspak të kënaqur deri në 4 = shumë të kënaqur);
- Qëllimi i klasës së fëmijëve 0-3 vjeç, një listë me 14 pika që përfaqësojnë qëllimet, që mund të kenë klasat e fëmijëve 0-3 vjeç dhe rolin profesional që mund të marrin edukatoret e fëmijëve 0-3 vjeç (14 pyetje të matura në një shkallë nga 1 = aspak dakord deri në 4 = shumë dakord);
- Raporti me prindërit, një pyetje specifike mbi idenë që edukatoret kanë për nivelin e kënaqshmërisë së prindërve ndaj fëmijëve, nxënës lidhur me zgjedhjen e institucionit parashkollor (shkallë me 5-pikë nga 1 = aspak në 5 = shumë) dhe 3 grupe pyetjesh të projektuara për të nxjerrë në pah, nga këndvështrimi i edukatoreve: a) motivet e prindërve lidhur me zgjedhjen për t'i dërguar fëmijët e tyre në institucionin parashkollor (9 pyetje të matura në një shkallë prej 4-pikësh nga 1 = kurrë / pothuajse asnjëherë deri në 4 = shumë shpesh); b) informacionin që prindërit zakonisht ia kërkojnë personelit të institucionit parashkollor (10 pyetje të matura në një shkallë prej 4-pikësh nga 1 = kurrë / pothuajse kurrë në 4 = shumë shpesh); c) vështirësitë që mund të hasin prindërit, të cilët e çojnë fëmijën në institucionin parashkollor (11 pyetje të matura në një shkallë prej 4-pikësh nga 1 = kurrë / pothuajse asnjëherë, deri në 4 = shumë shpesh).

Temat e pyetësorit janë identifikuar duke marrë nxitje nga pyetësorët e përdorur në hulumtimin empirik për punonjësit, dhe në veçanti ata që punojnë në shërbimet për fëmijërinë e hershme (ECEC) dhe në edukimin parashkollor dhe rishikimi i sintaksës dhe strukturës në funksion të hulumtimit specifik, që do të kryhej dhe përkthimi në gjuhën shqipe.

Versioni final i pyetësorit (Shtojca 1) është plotësuar më pas me një letër prezantimi (Shtojca 2) për edukatoret që do të merrnin pjesë në hulumtim.

Përshkrimi i rezultateve do të bëhet sipas skemës së mëposhtme:

1. Analiza e karakteristikave socio-civile të subjekteve, duke theksuar edhe çdo lloj ndryshimi ndërmjet edukatoreve, që punojnë në institucionet publike (ESPub) krahasuar me ata që punojnë në institucionet private (ESPri);
2. Vështrimi përshkrues i ecurisë së rezultateve të nxjerra nga e gjithë mostra, që do të ndihmojë në identifikimin e dimensioneve kryesore për secilin tregues;
3. Vlerësimi i ndikimit të moshës në përvojën profesionale të edukatores;
4. Nxjerrja në pah e ndryshimeve eventuale ndërmjet edukatoreve në institucionet publike (ESPub) dhe edukatoreve në institucionet private (ESPri) në rezultatet e nxjerra në pikën 2;

5 Krahasimi ndërmjet edukatoreve që kryejnë veprimtaritë e tyre në tri lloje të ndryshme të shërbimeve (çerdhe 0-3, kopsht 3-5, grup parashkollor 5-6), për të vlerësuar nëse nga të tri grupet ka ndryshime lidhur me qëllimet që duhet t'i ndjekë grupi 0-3,[2] para faktit që plan-programi i ri nuk parasheh asnjë tregues për grupin 0-3, që është ende në pritje të një dokumenti zyrtar;
6 vlerësimi i ndryshimeve eventuale në rezultatet e marra në pikën 2, në funksion të përgatitjeve të ndryshme profesionale të edukatoreve.

Pyetësori i drejtuar prindërve

Me pyetësorin për prindërit kemi propozuar t'i hulumtojmë sektorët e mëposhtëm:

- *Të dhënat e llojit socio-civil,* personal dhe familjar;
- *Arsyet që lidhen me zgjedhjen për ta dërguar fëmijën e tyre në institucionin parashkollor*, një listë me 13 arsyet e mundshme (shkallë me 2 pikë 1 = po 2 = jo);
- *Pjesëmarrjen në institucionin parashkollor dhe zhvillimi i fëmijëve (përfaqësimi i funksionit të parashkollorit në zhvillimin e fëmijës),* dy grupe pyetjesh përmes të cilave prindërve iu është kërkuar të tregojnë : a) ndryshimet ndërmjet fëmijëve që e frekuentojnë institucionin parashkollor dhe atyre që nuk e frekuentojnë institucionin parashkollor (12 pyetje të matura në një shkallë nga 1 = aspak dakord 4 = shumë dakord); b) përfitimet e fëmijës së tij për shkak të ndjekjes së institucionit parashkollor (7 pyetje të matura në një shkallë me nga 1 = aspak dakord deri në 4 = shumë dakord);
- *Vlerësimi i hapësirave dhe organizimit të institucionit parashkollor,* 3 grupe pyetjes përmes të cilëve prindërve iu është kërkuar t'i : a) vlerësojnë hapësirat e brendshme të institucionit parashkollor (7 pyetje të matura në një shkallë më 3-pikë 1 = po, 2 = jo, 3 = nuk e di); b) vlerësojnë hapësirat e jashtme të institucionit parashkollor (8 pyetje të matura në një shkallë me 3-pikë 1 = po, 2 = jo, 3 = nuk e di); c) zbulojnë nevojat e veçanta ose kërkesat e prindërve lidhur me orarin e hapjes së institucionit (5 pyetje të matura në një shkallë me 2 pikë 1 = po, 2 = jo);
- *Vlerësimi i marrëdhënieve ndërmjet familjes dhe institucionit parashkollor,* dy grupe pyetjesh përmes të cilave ishte e mundur të zbulohet se si i vlerësojnë prindërit: a) mënyrat për mbajtjen e kontakteve ndërmjet anëtarëve të familjes dhe edukatoreve (intervista, takime, etj.) (5 pyetje të matura në shkallë me 4 pika 1 = po, 2 = mjaft, 3 = jo, 4 = nuk e di); b) mënyrat në të cilën shkolla i pranon fëmijët (5 pyetje të matura në një shkallë me 4 pikë 1 = po 2 = mjaft, 3 = jo, 4 = nuk e di);

Kënaqshmëria me personelin e institucionit parashkollor, dy grupe pyetjesh përmes të cilave prindërit janë pyetur për të vlerësuar: a) personelin shkollor (6 pyetje të matura në një shkallë *nga 1 = aspak deri më 4 = shumë), b) personeli ndihmës* i institucionit parashkollor (5 pyetje të matura në një shkallë nga 1 = aspak deri në 4 = shumë);

Temat e pyetësorit janë evidentuar duke marrë shkas nga pyetësorët e përdorur në kërkimet empirike mbi prindërit.

Versioni përfundimtar i pyetësorit (Shtojca 1) u plotësua më pas me një letër prezantimi (Shtojca 2) për prindërit pjesëmarrës në hulumtim.

Përshkrimi i rezultateve do të kryhet sipas skemës së mëposhtme:

1 Analiza e karakteristikave socio-demografike e prindërve që kanë plotësuar pyetësorin dhe e familjeve të tyre;
2 Përshkrimi i ecurisë së rezultateve të kryera në tërë mostrën, që do ta mundësojë identifikimin e dimensioneve kryesore për secilin tregues.

2 Në veçanti:
A. Cavalli (nën kujdesin e), *Të japësh mësim sot. Hulumtimi i parë IARD mbi kushtet e jetës dhe të punës në shkollën italiane,* Il Mulino, Bologna, 1992 e A. Cavalli (në kujdesin e), *Edukatorët në shkollën që ndryshon. Hulumtimi i dytë IARD mbi kushtet e jetës dhe të punës në shkollën italiane,* Il Mulino, Bologna, 2000; L. Galliani e E. Felisatti (nën kujdesin e), *Mësimdhënësit në Universitet. Modeli empirik dhe cilësia e formimit fillestar të edukatorëve: rasti Padova,* Pensa MultiMedia, Lecce, 2001; Galliani e E. Felisatti (nën kujdesin e), *Mësimdhënësit në Universitet. Planprogrami, eksperienca dhe profesioni. 2° Raporti kërkimor në rastin Padova,* Pensa MultiMedia, Lecce, 2005.

EDUKATORET E INSTITUCIONE-VE PARASHKOLLORE – KARAK-TERISTIKAT PROFESIONALE

Përshkrimi i Mostrës

Në hulumtim morën pjesë 231 subjekte (226 femra, 2 meshkuj dhe 3 që nuk tregojnë gjininë e tyre) ndërmjet moshës 20 dhe 65 vjeçare (mosha mesatare 42,88 vjeç, ds = 11.04). Shifra përfaqëson një rezultat shumë të mirë në qoftë se mendohet se numri i përgjithshëm i edukatoreve, që punojnë në sistemin parashkollor publik ishte 511 njësi në tërë Kosovën në vitin 2013 (të dhënat e Ministrisë 2012/ 2013). Në lidhje me pjesëmarrjen në përgjithësi, vërtetohet tendenca jashtëzakonisht e përhapur e marrjes së detyrave mësimore dhe e kujdesit ndaj fëmijëve, veçanërisht e atyre nën tre vjeç, pothuajse ekskluzivisht nga stafi femëror. Krahasuar me të dhënat kombëtare, të anketuarat përfaqësojnë një grup mjaft heterogjen, më shumë në moshën e rritur. Në përgjithësi, kemi 8 subjekte (3.5 %) me më pak se 25 vjeç, 54 (23.4 %) me moshë midis 26 dhe 35 vjeç, 69 (29.9 %) ndërmjet 35 dhe 45 vjeç dhe 94 (40.7 %), pjesa më e madhe, me më shumë se 45 vjeç, 6 subjekte (2.6 %) nuk e deklarojnë moshën. Kur krahasojmë të dhënat e lartpërmendura me rezultatin e kërkimeve të ngjashme evropiane, ndryshon në lidhje me moshën mesatare të popullsisë së vendit siç tregohet edhe në dokumentet e konsultuara.

Statusi martesor, shkalla e arsimimit dhe përvojat e mëhershme profesionale tregojnë

Në lidhje me statusin martesor, 183 subjekte (79.2%) janë të martuar /bashkëjetojnë, 28 (12.1%) beqarë / beqare, 14 (6.1%) të ve, 3 (1.3%) të ndarë ose të shkurorëzuar, dhe 3 (1.3%) fetarë. Shumica e edukatoreve në mostrën tonë janë të martuar dhe shumë prej tyre kanë fëmijë: 82.7% (191) thonë se janë prindër dhe mes tyre shumica kanë disa fëmijë: 21 (13.6%) subjekte me vetëm një fëmijë, 69 (36.1%) me dy, 65 (34%) me 3 dhe 31 (16.2%), me 4 ose më shumë fëmijë. Në total 473 fëmijë (mesatarisht 2.5 fëmijë për frymë).

Shumica e subjekteve që iu përgjigjën pyetësorit, sipas moshës së tyre, statusit martesor dhe strukturës së familjes, rezulton se jetojnë në atë që përkufizohet si mosha kryesore e moshës madhore, në të cilat gratë kanë bërë tashmë zgjedhje shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë si me jetën profesionale dhe me atë të punës. Në rastin e punësimeve në fushën e edukimit dhe atë të përkujdesit, kjo e dhënë është veçanërisht e rëndësishme e sidomos për ata që punojnë me fëmijët nga 0 në 3 vjeç, ku puna kërkon karakteristika shumë të ngjashme me ato të ambientit shtëpiak, me rëndësi në lidhje qoftë me identitetin personal qoftë me atë profesional (Cover, Columbus, Bianchi 2004).

Arsimimi i të anketuarve është një tregues tjetër me interes, për shkak të lidhjes midis cilësisë së arsimimit dhe profesionalizmit të edukatoreve, si dhe lidhjes ndërmjet aftësisë të lartë profesionale dhe larmishmërisë së kursit të studimit përgatitor për profesionin (CORE, 2011). Ndaj, rekomandohet një edukim universitar (ISCED 5) për edukatoret që punojnë në sektorin 0-6 dhe një planprogram i përqendruar në aftësitë me natyrë psiko-pedagogjike.

Për sa i takon kualifikimit përkatës, 66 (28.6%) e subjekteve deklarojnë se kanë një diplomë të Shkollës së Mesme të Mjekësisë, 60 (26%) me diplomën e Shkollës së Lartë, 57 (24.7%) diplomën e Fakulteti të Edukimit (Fakulteti Edukimit, Fillor), 18 (7.8%) diplomën e Fakultetit Pedagogjik (Fakulteti Pedagogjik, pedagogji e përgjithshme), 3 (1.3%) diplomë në edukim fillor, Fakulteti i Edukimit (Fakulteti Edukimit, Fillor), 3 (1.3%) diplomë në Mësimdhënie të lëndëve (matematikë, fizikë, gjuhë, etj.) të Fakultetit të Edukimit (Fakulteti Edukimit, Lëndore) dhe së fundi, vetëm (0.4%), diplomën për edukim inkluziv/ special (Fakulteti Pedagogjik, edukimi inkluziv / special).

Nga hulumtimi doli që trajnimi i edukatoreve, të cilat iu përgjigjën pyetësorit nuk është i njëtrajtshëm, dhe duket se shfaq një natyrë të dyfishtë: një qasje mjeko-shëndetësore, veçanërisht për edukatoret që punojnë me grup moshën 0-3, dhe qasja e edukatoreve të tjera është më edukative.

Puna e edukimit kryhet në pjesën më të madhe nga ata të cilët kanë përfunduar një kurs profesional, dhe fillon të jetë e rëndësishme edhe prania e edukatoreve, që kanë një diplomë universitare (rreth 34%).

Fakti që bashkëjetojnë profesione kaq të ndryshme, në të njëjtat institucione mund të lexohet si një sinjal ndryshimesh, të cilat Qeveria e Kosovës është duke u përpjekur t'i kryejë në institucionet parashkollore, duke sugjeruar një ndryshim progresiv larg nga një model i institucionit parashkollor (dhe edukatoreve) të tipit socio-kujdestar drejt atij ku vlerësohet vlera edukative e përvojës së fëmijës jashtë ambientit shtëpiak. Konotacioni i këtij aspekti të 'edukimit' në fakt mbështetet nga informacionet e dhëna në tekstin e Ligjit Nr 02/L-52 "Për edukimin parashkollor", ku në nenin 28 përcaktohet kualifikimi edukativ, që edukatoret duhet ta zotërojnë[3] dhe është sugjeruar edhe nga PSAK (2011) i cili thotë: "Përmirësimi i stafit që punon me fëmijët e moshës 0-3. Shumica e stafit që punon me fëmijët e moshës 9 muaj / 3 vjeç kanë një kualifikim mjekësor me arsim të mesëm, dhe kanë shumë pak ose aspak trajnim edukativ. Kjo është e lidhur ngushtë me cilësinë e shërbimeve të ofruara."

Duke pasur parasysh pabarazinë e kualifikimit bazë bëhet i rëndësishëm investimi në përmirësimin e shërbimit, me qëllimin kryesisht për mbështetjen e njohurive dhe kompetencave themelore të profesionalizmit, veçanërisht ato me natyrë psiko-pedagogjike.

Tab. 1 Punësimi i mëhershëm para punës si edukatore

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Të vlefshëm	Punësimi i parë	129	55,8	57,3	57,3
	Në Institucione të tjera shkollore	13	5,6	5,8	63,1
	Në institucione të tjera parashkollore	16	6,9	7,1	70,2
	Në çerdhe të tjera	8	3,5	3,6	73,8
	Në shkollën fillore	21	9,1	9,3	83,1
	Në ambiente të tjera shkollore	2	,9	,9	84,0
	Në ambiente mjekësore	19	8,2	8,4	92,4
	Në sektorë të tjerë të adm. Publike	6	2,6	2,7	95,1
	Tjetër	11	4,8	4,9	100,0
	Totali	225	97,4	100,0	
Mungojnë	Mungojnë në sistem	6	2,6		
Totali		231	100,0		

3 Neni 28.4. Edukatorët duhet të kenë si vijon:
a) Diplomën e Fakultetit të Edukimit – programi parashkollor
b) Shkollën e Lartë Pedagogjike – drejtimi për edukatorë
c) Fakultetin Filozofik – dega e Pedagogjisë
d) Diploma të fakulteteve arsimore, të plotësuara me trajnime adekuate për edukatorë parashkollorë e të certifikuara nga MASHT-i.

Kur u pyetën për të treguar se çfarë pune kanë bërë para se të bëheshin edukatore, shumica u përgjigjën se e tanishmja është puna e tyre e parë; grupet më pak konsistente thanë se kishin punuar në shkollat fillore, në shëndetësi ose në institucione të tjera parashkollore (Tabela 1). Fakti që shumë nga edukatoret kanë hyrë në botën e edukimit pa ndonjë përvojë shtesë të punës, i jep edhe më shumë rëndësi trajnimit të tyre fillestar dhe mbështet nevojën për një program mësimor, në të cilin zë një vend të rëndësishëm një periudhë trajnimi nëpër institucione, në mënyrë që të favorizohet krijimi i një rrethi virtuoz mes njohurive teorike dhe aftësive praktike kryesore në profesionalizmin e çdo edukatori/eje (Raporti i Progresit i përbashkët mbi implementimin e Arsimit dhe Trajnimit 2010, programi i punës, 2010b; Konkluzionet e Këshillit për zhvillimin profesional të edukatoreve dhe drejtorëve të shkollave, 2009c; Komunikimi 'Përmirësimi i kompetencave për shekullin 21: një agjendë për bashkëpunim evropian nëpër shkolla, 2008b).

Tipologjia e Shërbimit

Edukatoret shpërndahen në këto tipologji të shërbimeve (Tab. 2):

Tab. 2 Shpërndarja e Edukatoreve sipas tipologjisë së shërbimeve

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme
Të vlefshme	Parashkollor (0-3)	71	30,7	31,7
	Parashkollor (3-5)	86	37,2	38,4
	Para-fillor (5-6)	52	22,5	23,2
	Tjetër	15	6,5	6,7
	Totali	224	97,0	100,0
Mungojnë	Mungojnë në sistem	7	3,0	
Totali		231	100,0	

Të dhënat në lidhje me shpërndarjen e të anketuarve në lidhje me moshën e fëmijëve me të cilët ata punojnë, është për t'u vendosur në lidhje me zgjedhjen e institucioneve parashkollore të parashikuara për mostër, të cilat përjashtojnë ato shkolla në të cilat kishte vetëm klasa 'para-fillore'.

88.3% (V.A. 204) e subjekteve punon në një institucion publik, ndërsa 11.7% (V.A. 27) për një subjekt privat.

Kur u pyetën për të treguar se sa fëmijë marrin pjesë në shërbimin në të cilin punojnë, edukatoret janë përgjigjur duke treguar një gamë nga 45-450 fëmijë; nga 5 në 37 është numri në çdo klasë. Edhe një herë, pamja që del nga të dhënat është heterogjene: janë përfaqësuar institucione parashkollore shumë të mëdha dhe institucione parashkollore të vogla, me grupe ku ka pak fëmijë (5) e grupe me shumë, madje tepër (37).

Shumica e edukatoreve pohojnë se punojnë me një ose dy kolegë të tjerë (Tabela 3); ky tregues nënvizon rëndësinë e mbështetjes së punës së grupit edukativ (të grupit kryesor të edukatoreve) në një perspektivë të bashkëpunimit, të këmbimit dhe mbështetjes reciproke, si dhe të grupit më të gjerë, në rastin e institucioneve parashkollore me një numër të lartë të grupeve.

Tab. 3 Numri i edukatoreve që punon me të anketuarin

		Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja kumulative
Të vlefshme	1	119	51,5	52,0	52,0
	2	97	42,0	42,4	94,3
	3	12	5,2	5,2	99,6
	8	1	,4	,4	100,0
	Totali	229	99,1	100,0	
Mungojnë	Mungojnë në sistem	2	,9		
Totali		231	100,0		

Karakteristikat e edukatoreve që punojnë në shërbimet publike (ESPub) krahasuar me ato private (ESPri)

Duke krahasuar edukatoret që punojnë në shërbimet publike dhe ato që punojnë në shërbimet private, mund të shohim se të parat rezultojnë më me përvojë si nga mosha ashtu edhe nga profesionalizmi (Tab. 4).

	Edukatore në shërbimet publike (N)	Edukatore në shërbimet private (N)	df	F	Sig.
Mosha	43,95 (198)	34,96 (27)	1-224	16.87	.000
Përvoja Profesionale	16,34 (184)	5,81 (26)	1-209	21.99	.000

Sa i përket kualifikimit (Tabela 5), vëmë re se në mesin e ESPri-t është më shumë e pranishme në përqindje diplomimi në Edukimin parashkollor të Fakultetit të Edukimit (Fakulteti i Edukimit, Parashkollorë), ndërsa në mesin e ESPub diploma e Shkollës së Mesme të Mjekësisë (Shkolla e Mesme e Mjekësisë) ose (Shkolla e Lartë).

Në linjë me vendet e tjera evropiane, në të cilat ka shërbime parashkollore, si publike ashtu edhe private, shpesh sektori privat është zona e parë e qasjes në tregun e punës, dhe kjo shpjegon moshën më të re të edukatoreve në këtë sektor, si dhe kualifikimin profesional fillestar më të lartë. Në vitet e ardhshme do të jetë interesante të ndiqet ecuria e tregut të punës në këtë sektor, për të parë nëse sektori privat do të jetë një hap i parë për një qasje të mëvonshme në sistemin publik, ose nëse kërkesa për shërbimet sociale do të sjellë një zgjerim të sektorit privat në kurriz të investimeve në sektorin publik. Nevoja për shërbime edukuese dhe kujdesi për fëmijërinë e hershme është, në fakt, në rritje të ndjeshme sidomos në afërsi të qendrave të mëdha urbane, për ta mbështetur zhvillimin e punës, veçanërisht të grave. Dhe, kjo mund të jetë një fushë e investimeve për bizneset lokale (USAID, 2011).

Tab. 5 Kualifikimi profesional: Krahasimi ndërmjet edukatoreve në shërbimet publike (ESPub) dhe edukatoreve në shërbimet private (ESPri)

Kualifikimi profesional	Publik (ESPub) % (N)	Privat (ESPri) % (N)
Shkolla e Mesme e Mjekësisë (gjimnazi)	32.3 (60)	27.3 (6)
Shkolla e Lartë	31.2 (58)	9.1 (2)
Fak. i Pedagogjisë, Pedagogjia e Përgjithshme	9.1 (17)	4.5 (1)
Fak. i Pedagogjisë, Edukimi inkluziv/special	0 (0)	4.5 (1)
Fak. i Edukimit, Parashkollore	25.8 (48)	40.9 (9)
Fak. i Edukimit, Fillore	1.6 (3)	0 (0)
Fak. i Edukimit, lëndore (matematikë, fizikë..)	0 (0)	13.6 (3)
Totali	100 (186)	100 (22)

Nuk ka një ndryshim thelbësor mes dy grupeve në lidhje me shërbimin, në të cilën ato janë punësuar, por një prevalencë e lehtë e ESPub-it në klasat për fëmijët 0-3 vjeç (32.8% ndaj 23.1%) dhe ESPri-t në grupet para-fillore (30.8% ndaj 22.2%).

Gjithashtu, nëse shohim numrin e fëmijëve që frekuentojnë institucionet, mund të themi se ato publike rezultojnë me numër shumë më të madh sesa ato private: ESPub thonë se ata punojnë në objekte që mund të kenë nga një minimum prej 70 në një maksimum prej 450 fëmijë, ndërsa gama për ESPri është 45-123 fëmijë.

Nuk duket të jetë një ndryshim mjaft i madh në numrin për grupe: të ESPub thonë se ata punojnë me grupe me nga 8 deri në 37 fëmijë, ndërsa ESPri me grupe me nga 5 deri në 34 fëmijë.

Për të konfirmuar se shërbimet publike kanë dimensione më të madhe se ato private, vihet re se vetëm në ESPub, thonë se punojnë me një numër të kolegëve të barabartë ose më të madh se tre, ndërsa në ESPri, pohojnë se bashkëpunojnë me dy kolegë maksimumi.

Motivimet e zgjedhjes profesionale

Për t'i hulumtuar arsyet që i kanë shtyrë ta zgjedhin profesionin e tyre, subjektet janë pyetur për të treguar shkallën e rëndësisë[4] në një listë të arsyeve, motivimeve për profesionin e edukatorit/es. Nëpërmjet analizës së komponentëve kryesore (rotacioni varimax) u bë i mundur grupimi i motivimeve në 3 dimensione: "Prirja", duke iu referuar arsyeve të tipit prirje, "Vlera e edukimit ndërmjet traditës dhe inovacionit", që afron zgjedhjen profesionale të lidhur me historinë e tyre të jetës personale dhe familjare, me dëshirën që të ndikojë në realitetin edukativ përmes ndërhyrjeve inovative dhe eksperimentimit, dhe "Vlerësimi personal", duke iu referuar motivimeve më shumë në nivelin individual dhe personal (tab. 6).

Të tri dimensionet paraqesin një vlerë të mesme të lartë. Në veçanti, "Prirja" rezulton të jetë një dimension shumë i rëndësishëm pasi tregon për një mesatare të afërt me vlerën maksimale 4.

Ajo që del në pah në analizën e Tab. 6 është që profesioni i edukatores edhe sot paraqet një punë shumë të dëshiruar pasi pranohet në aspektin social dhe rezulton gjithashtu të jetë një vend për realizimin e aspiratave. Sipas përgjigjeve të dhëna jepet pamja e një profesioni që pa shumë "mund", të lejon të shprehësh subjektivitetin tënd, duke kontribuar në mënyrë origjinale dhe kreative në institucionin parashkollor. Nevoja për ndryshim kapet fort pas idesë se, për të punuar me fëmijët e ciklit parashkollor, "Prirja" dhe pasioni për fëmijët janë ndër motivimet më të rëndësishme.

4 shkallë me 4 pikë (aspak e rëndësishme, pak e rëndësishme, mjaft e rëndësishme, shumë e rëndësishme)

Tab. 6 Motivimet për profesionin. Mesatarja dhe devijimet standarde

Motivimet për profesionin	N	Mesatarja	Devij. Stand.
"PRIRJA"	**223**	**3.71**	**.39**
Kisha dëshirë të punoja me fëmijët	227	3.77	.483
E ndjeja vokacionin për edukim	231	3.75	.506
Kisha interes/pasion për edukimin	227	3.70	.531
Edukimi është një punë që më lejon të shpreh autonomi dhe kreativitet	227	3.61	.631
VLERA E EDUKIMIT NDËRMJET TRADITËS DHE INOVACIONIT	**219**	**3.44**	**.60**
Edukimi është një punë koherente me llojin e shkollës së lartë që kam ndjekur	224	3.56	.660
Për ta përmirësuar cilësinë e edukimit në institucionin parashkollor	226	3.54	.660
Edukimi vazhdon një traditë familjare	226	3.19	1.075
VLERËSIMI PERSONAL	**223**	**3.37**	**.57**
Edukimi është një punë që më lejon të rritem edhe në planin personal	227	3.52	.700
Besoja në vlerën sociale të edukimit	225	3.46	.694
Edukimi lejon kohë të lirë për jetën private, familjen dhe fëmijët	227	3.31	.794
Edukimi është një punë e garantuar me një pagë diskrete	227	3.16	.948

Edukatore ideale

Përfaqësimi i edukatores ideale është hulumtuar përmes dy pyetjeve: subjekteve u është kërkuar ta tregonin shkallën e rëndësisë lidhur me: (a) disa "Aspekte që lejojnë identifikimin e një edukatori/eje të mirë"; (b) "Dijeve që duhet të ketë një edukator/e e mirë". Me pyetjen e parë është dashur të hulumtohet në terma më të përgjithshëm, se cilat janë fushat që sipas gjykimit të tyre përbëjnë profesionalizmin; me të dytën, prania e një modeli psiko-pedagogjik të qartë.

Në lidhje me "Aspektet e rëndësishme për të identifikuar një edukator të mirë" (a), analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) tregon ekzistencën e 4 nën-dimensioneve (Tab-7): "Kënaqshmëria e nxënësve", " Përgjegjësia dhe angazhimi për të qenë një edukator "," Aftësitë pedagogjike/didaktike " dhe " Kompetencat organizative /menaxheriale. "

Duke parë pikët mesatare të dimensioneve, është e qartë se për mostrën është shumë e rëndësishme që një edukatore të dijë si t'i përmbushë nevojat e fëmijëve, kuptohet si në lidhje me fëmijët, ashtu edhe me të rriturit (prindërit).

Në vendin e dytë për sa i takon rëndësisë, gjejmë ndërgjegjësimin se për t'u bërë (dhe për të qenë) një edukator i mirë duhet angazhimi në prova vlerësimi dhe përzgjedhjeje, të punosh me seriozitet dhe përgjegjësi dhe të jesh i aftë të bashkëpunosh me kolegët ("Përgjegjësia dhe angazhimi për të qenë edukator"). Ky dimension duket me interes të veçantë, pasi dimensioni kolegjial lexohet këtu si një detyrë morale dhe etike, më tepër se sa një shprehje e një kompetence specifike profesionale.

"Kompetencat pedagogjike/didaktike" paraqiten vetëm në vendin e tretë, por me pikë mesatare, që megjithatë vendosen ndërmjet "mjaftueshëm" dhe "shumë e rëndësishme", dhe përfshijnë aspekte që lidhen drejtpërdrejt me dimensionin pedagogjik/didaktik të punës së edukatorit/es. Së fundi, me pikë mesatare të barabarta me ato të dimensionit të tretë, ndodhet "Kompetencat organizative/menaxheriale", ose ndërgjegjësimi se për të qenë një edukator i mirë, dhe për t'u njohur si i tillë, duhet të mbash

disiplinën në klasë dhe të dish ta organizosh dhe ta menaxhosh punën në mënyrë efikase.[5]

Treguesit tentojnë ta japin pozitën e një edukatori/eje ideal/e ku mbizotëron roli institucional dhe funksioni social: edukatori/ja përfaqëson, edhe në planin moral, komunitetin dhe atij duhet t'i përgjigjet në nivele të ndryshme të sistemit, duke filluar nga fëmijët dhe familjet e tyre për të arritur te komuniteti në përgjithësi.

Për këtë motiv, një edukator i mirë është edhe në gjendje të kalojë verifikime dhe prova përzgjedhje-je. Kompetencat pedagogjike/didaktike dhe ato menaxheriale kalojnë në planin e dytë në përfaqësimin e profesionalizmit; dhe njohja profesionale në nivelin lokal konsiderohet sekondare. Si të thuash, edukatori/ja ideal/e ka të bëjë më shumë me atë që është, ose më mirë themi atë që përfaqëson në planin e vlerave, sesa me atë që bën dhe vepron profesionalisht në jetën e përditshme në klasë.

Tab. 7 Aspekte të rëndësishme për të identifikuar një edukator të mirë. Mesatarja dhe devijimet standarde

Aspekte të rëndësishme për ta identifikuar një edukator të mirë	Nr	Mesatarja	Devij. Stand.
KENAQËSHMËRIA E NXËNËSVE	**228**	**3.79**	**.466**
Niveli i kënaqshmërisë së fëmijëve dhe familjeve	228	3.79	.466
PËRGJEGJËSIA DHE ANGAZHIMI PËR TË QENË EDUKATOR	222	3.63	.48
Serioziteti ndaj detyrave civile dhe profesionale	229	3.72	.512
Aftësia për të punuar në grup me kolegët	228	3.70	.579
Aftësia për të kaluar prova përzgjedhëse dhe/ose prova vlerësuese	225	3.47	.720
KOMPETENCAT PEDAGOGJIKE/DIDAKTIKE	**216**	**3.54**	**.51**
Aftësia për t'i dalluar potencialet dhe për ta vlerësuar cilësinë e performancave të fëmijëve	227	3.63	.642
Kapaciteti/Aftësitë e fituara nga fëmijët	227	3.63	.597
Aftësia për t'i përfshirë fëmijët	224	3.60	.590
Gatishmëria për të dedikuar kohë shtesë në punë	227	3.29	.827
KOMPETENCAT ORGANIZATIVE/MENAXHERIALE	**210**	**3.54**	**.55**
Njohja e kompetencës dhe efikasitetit në institucionin parashkollor ku punon	224	3.54	.662
Aftësia për ta "mbajtur disiplinën"	220	3.53	.685
Zotësia për t'i përshtatur aftësitë organizative dhe menaxheriale	223	3.52	.683

Pyetja lidhur me "Dijet e një edukatori/je të mirë" ka si qëllim analizimin në mënyrë më të thellë të disa komponentëve, që lidhen me modelet pedagogjike në bazë të paraqitjeve të imazhit ideal të edukatorit/es.

Kompetencat e propozuara i referohen modeleve të ndryshme psiko-pedagogjike (Montessori, 1950, 1970; Goldschmield, 1979; Pikler, 1990; Bertolini et al. 1988) tashmë të përhapur; pyetja drejtohet për ta evidentuar disa modele në imazhet e përbashkëta dhe në atë që përfaqësojnë edukatoret.

Disa pyetje iu referohen modelit të dhuntive. Pra, atyre kompetencave të lindura lidhur me karakterin subjektiv, sidomos atë femëror (të qenit i qasshëm, të dish ta ruash kontrollin, t'i bësh të të binden),

5 shkallë me 4 pikë (aspak e rëndësishme, pak e rëndësishme, mjaft e rëndësishme, shumë e rëndësishme)

që të bashkangjitura me kompetencat e llojit mjekësor janë tipike të modeleve tradicionale të shërbimeve në fëmijëri - më shumë e një qasjeje kujdestarie sesa edukative.

Një model i dytë i hipotetizuar është ai që privilegjon nevojat afektive të fëmijës - rëndësia për një zhvillim të mirë të afrimit të fëmijës me të rriturin (Boëlby, Mantovani).

Kësaj rryme i referohen pyetjet e anketës, si: Përballja me momentet problematike të rritjes së fëmijëve – si të dish të krijosh një klimë familjare në çerdhe; - si të kesh raporte individuale me fëmijët; - si të kesh raporte të thella me fëmijët në planin afektiv? Sikurse, në studimin e Ongari-Molina (2005), edhe në rastin tonë, kjo pyetje e fundit, është futur me funksion kontrollues, dhe "sigurisht kjo nuk i referohet kur është fjala për dimensionin emocional-relacional (krijimit të marrëdhënieve) si një element thelbësor për zhvillimin e duhur të fëmijës" (91). Kjo pyetje synonte të shihte nëse dimensioni i marrëdhënieve lidhej më shumë me ndërveprimin dhe raportin individual ose i referohej në përgjithësi një "raporti afektiv".

Pyetja lidhur me njohurinë për t'i paraqitur përvojat e pasura dhe të larmishme; për ta favorizuar shoqërimin në grupin e fëmijëve; për ta zbatuar një program të mirë didaktik; për t'iu shpjeguar prindërve arsyen e zgjedhjeve të bëra edukative, që kanë të bëjnë në përgjithësi me atë që bëhet në IP me fëmijët, si dhe me mënyrën se si komunikohen zgjedhjet personale pedagogjike dhe didaktike; modeli më poshtë lidhet pikërisht me planifikimin.

Së fundi, një grup pyetjesh ishin lidhur me marrëdhënien me dimensionin social të institucionit parashkollor, qoftë në kuadrin e tij, qoftë ndaj subjekteve të ndryshme: - Përgjigjja ndaj kërkesave të prindërve dhe bashkëpunimi me administratën publike.

Të dhënat tregojnë se analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) ka rikthyer tri dimensione (Tab-8), duke demonstruar se perceptimi që edukatoret kanë për profesionin e edukatoreve ndërtohet duke bashkuar qasje të ndryshme teorike. Dimensionet e paraqitura janë si më poshtë: "Njohuritë didaktike", kompetenca të lidhura ngushtë me aktivitetin didaktik të edukatorit/es, "Të dish të jesh i përkushtuar me të rriturit", ose ato kompetencat e tërthorta në punën e edukimit që lejojnë lidhjen me të rritur të tjerë, të pranishëm në sistemin shkollor (prindër dhe kolegë), dhe "të dish të jesh i lidhur me fëmijën", i referohet aftësisë së edukatorit/es për ta filluar dhe për ta mbajtur një lidhje me fëmijën.

Duke parë pikët mesatare, të 3 njohuritë, merren si mjaft të rëndësishme për t'u konsideruar një edukator i mirë.

Tab. 8 Një edukator i mirë duhet të dijë.... Mesatarja dhe devijimet standarde

Njohuritë që duhet t'i ketë një edukator i mirë	Nr	Mesatarja	Devij. Stand.
NJOHURITË DIDAKTIKE	**229**	**3.79**	**.36**
Ta bëjë një planifikim të mirë të aktiviteteve	231	3.87	.378
T'u paraqesë fëmijëve përvoja të pasura dhe të larmishme	229	3.72	.507
PËRKUSHTIMI ME PRINDËRIT	**221**	**3.70**	**.43**
Të jetë gjithmonë në dispozicion	226	3.73	.490
T'i këmbejë opinionet me kolegë	228	3.72	.539
T'u përgjigjet kërkesave të prindërve	228	3.63	.543
TË DIJË TË JETË I LIDHUR ME FËMIJËN	**209**	**3.66**	**.38**
Ta favorizojë socializimin e grupit të fëmijëve	231	3.75	.491
Ta krijojë një klimë familjare në institucionin parashkollor	229	3.75	.543
Të dijë si t'i binden	229	3.74	.523
T'i kontrollojë reagimet	230	3.70	.522
Të ketë raporte afektive të thella me fëmijën	228	3.69	.603
Të përballet me momentet problematike të rritjes së fëmijës	229	3.67	.565
T'u shpjegojë prindërve arsyen e zgjedhjeve edukative që ka bërë	228	3.67	.564
Të krijojë raporte shumë të individualizuara me fëmijët	229	3.65	.622

Në krahasim me modelet e shqyrtuara, referencat për kompetencat pedagogjike - didaktike janë themelore: edukimi i mirë në kopsht është ai edukim që di se si t'iu paraqesë fëmijëve përvoja të pasura dhe të larmishme, të planifikuara në kohën e duhur.

Një grup i dytë i kompetencave, që i përkasin edukatorit/es ideal/e janë ato që lidhen me dimensionin social dhe menaxherial të shërbimit. Vendosja e dimensionit të qasjes brenda kësaj zone (dhe asaj që lidhjet me fëmijët) duket se do të tregojë një problematikë tjetër, që vihet re në raportet me të rriturit, në krahasim me ato që vendosen me fëmijët. Tregues ky, i dalë në pah edhe nga rezultatet përkatëse të pyetjes mbi kënaqshmërinë lidhur me mësimdhënien, që do ta shqyrtojmë më pas.

Sa i përket punës me fëmijët, fakti që janë të shkrirë në një dimension të vetëm, si çështjet që i referoheshin më shumë modelit të një kopshti, që lidhet më shumë me një formë kujdestarie, sesa që lidhen më shumë me qëndrimet edukative, tregojnë edhe njëherë bashkëjetesën e këtyre dy qasjeve, që sigurisht lidhen me formimin e edukatoreve të intervistuara.

Duke u përpjekur për të dhënë një lexim të përgjithshëm të rezultateve të pyetjeve lidhur me edukatoren ideale, mund të themi se nga pamja që kemi paraqitet një profesionalizëm me konotacione tepër delikate, dhe nganjëherë të paqarta, që mund të lidhen me ndryshimet e shpejta që po ndodhin në këto institucione.

Edukatoret që i janë përgjigjur pyetësorit tregojnë se e konsiderojnë edukimin në kopsht si një profesion specifik, me një ndikim të fortë social, me konotacion në planin civil dhe atë të vlerave. Përmbajtjet profesionale, pra, janë si në aspektin deontologjik (të vlerave dhe përfaqësimeve sociale), ashtu edhe në atë pedagogjik-didaktik lidhur me aktivitetin, për atë që bëhet me fëmijët. Një profesion, natyra e të cilit mund të përkufizohet me karakter socio-edukativ, ku ndërhyrja edukative luhatet në mënyrë të pandërprerë ndërmjet një modeli programor, që nganjëherë është shumë i strukturuar, e ndonjëherë i lidhur me një planifikim pa afat.

Ky tregues do të mund të lexohej në këndvështrimin e një mangësie relative të modeleve psiko-pedagogjike të përbashkëta (Cili model fëmije? Cila teori zhvillimi? Një planifikim që fillon nga nevojat e fëmijës? Nga interesat e tyre?...) në një kontekst shkollor në të cilin, megjithatë, fleksibiliteti mbetet një vlerë dhe një nevojë.

Burimet e profesionalizmit

Një seksion i pyetësorit kishte për qëllim të hulumtonte burimet, që edukatorët /ret përdorin për ta kryer profesionin e tyre. Pyetja është për t'u konsideruar veçanërisht e rëndësishme, po të kemi parasysh se në Kosovë, si në shumë vende të tjera, nuk ka një program unik të formimit për të gjithë profesionistët, që punojnë në sektorin parashkollor. Në këtë profesion punojnë, siç e pamë në paragrafët më lart, edukatore me kualifikime të ndryshme për nga natyra disiplinore, kohëzgjatja dhe qëllimi i kualifikimit. Sipas këtij treguesi, përvoja e fituar drejtpërdrejt në këtë fushë, përmes punës praktike në institucionin parashkollor, mund të jetë një faktor që ndikon në mënyrë të konsiderueshme në përkufizimin e profesionalizmit të edukatoreve. Në periudhën e pasluftës, ka pasur disa projekte me interes në sektorin shkollor dhe parashkollor. Bëhet fjalë për kontributet që janë orientuar në problematika specifike (si p.sh. Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar në klasa normale, projekt i mbështetur nga 'Save the Children') ose në kontekste specifike (projekt drejtuar edukatoreve të Kopshtit nga ISSA), ose të destinuar për krijimin e mjeteve që mbështesin punën e edukatoreve dhe prindërve (Treguesit e zhvillimit të paraqitur nga UNICEF).
Projektet, të paraqitur shpeshherë si shumë të rëndësishme në planin e kualifikimi të punës së edukatoreve, edhe përgjatë intervistave me drejtuesit e shkollave të vizituara, janë karakterizuar nga përfshirja vetëm e disa institucione parashkollore dhe për një periudhë të kufizuar kohore, me ndikim shumë të dallueshëm nga njëri institucion parashkollor në tjetrin.

Një tjetër kontekst "kualifikimi", edhe pse joformal, është ai i lidhur me përvojën e edukatoreve si nëna, në përputhje me një model ende mjaft të përhapur që sheh në dhuntitë 'femërore' karakteristikat themelore për ata që punojnë me fëmijët, sidomos në grup-moshën 0-3 vjeç.

Në veçanti, janë hulumtuar dy burime: (a) burimet formale dhe joformale me të cilat shërbehen subjektet për të mësuar punën e tyre; (b) të qenurit prind të nxit dhe të bën të besosh që mund të jesh edukator më i mirë.

Përsa u takon burimeve formale dhe joformale, me të cilat shërbehen subjektet për të mësuar për ta kryer punën e tyre (a)[6], analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) nxjerr në pah praninë e 3 dimensioneve: "Kualifikimi fillestar dhe gjatë punës", i cili krahas studimeve shkollore dhe jashtë shkollore, përfshin edhe përvojën praktike profesionale; "Kualifikimi joformal" që ka të bëjë me përvojat e shkëmbyera në familje, me kolegët dhe të marra nga librat ose revistat; dhe "Vëzhgimi i të tjerëve", duke përfshirë në vëzhgim, jo vetëm sjelljen e kolegëve dhe të prindërve të fëmijëve, por edhe përvojat e realizuara në shkolla të tjera. Të tri dimensionet paraqesin pikë mesatare me rëndësi të lartë, ndërmjet "shumë" dhe "mjaft e rëndësishme".

6 Edhe në këtë rast subjektet u pyetën për t'u shprehur mbi rëndësinë mbi disa aspekte (shkallë me 4 punti, nga 1=për aspak e rëndësishme në 4=shumë e rëndësishme)

Tab. 9 Rëndësia e burimeve nga të cilat shërbehen edukatoret për ta kryer punën e tyre. Mesatarja dhe devijimi standard.

Burimet formale dhe joformale nga të cilat shërbehen për të kryer punën	Nr.	Mesatarja	Devij. Stand.
KUALIFIKIMI FILLESTAR DHE GJATË PUNËS	**226**	**3.75**	**.44**
Përvoja dhe praktika profesionale	230	3.77	.489
Kurset e mbajtura nga ekspertët	229	3.76	.551
Kualifikimi shkollor/universitar bazë	229	3.70	.561
KUALIFIKIMI JOFORMAL	**224**	**3.63**	**.45**
Përvoja personale dhe familjare	230	3.72	.495
Këmbimi i opinioneve me koleget në grupin e punës	228	3.67	.595
Libra dhe revista të specializuara	229	3.66	.558
VËZHGIMI I TË TJERËVE	**228**	**3.33**	**.63**
Përvoja të realizuara në shkolla të tjera	229	3.47	.729
Vëzhgimi i sjelljes së prindërve	230	3.52	.625
Vëzhgimi i sjelljes së kolegeve	228	3.13	.920

Sikurse mund të pritej, vëmë re se elementet e konsideruara si më të rëndësishmet në zhvillimin e profesionit përfaqësohen nga përvoja e akumuluar përgjatë viteve të punës dhe përvojës personale dhe familjare, së bashku me kurset e organizuara nga ekspertët. Më pak e rëndësishme është vlera që i jepet vëzhgimit të të tjerëve, si atij të prindërve dhe të kolegëve.

Në lidhje me atë që ndodh edhe në realitete të tjera, ku po punohet për kualifikimin e personelit në shërbim në kopshte, na duket e rëndësishme të nënvizojmë faktin që edukatoret tentojnë ta konsiderojnë kualifikimin nga bagazhi i përvojës, si më të duhur dhe që i përgjigjet më shumë nevojave të tyre sesa ato që kanë natyrë teorike, shpesh të perceptuara si të larguara nga jeta shkollore e përditshme. Ky tregues nuk na jep një sugjerim lidhur me përbërësit e kualifikimit, por për metodën: edukatoret perceptojnë si shumë efikase dhe kuptimplotë lidhur me profesionin e tyre, një formim në të cilin vlerësohen përvojat dhe puna në këtë fushë, e cila pajisë edhe me elemente kulturore dhe jo vetëm operative. Të dhënat, gjithashtu theksojnë se edhe në përvojat e edukatoreve është për t'u preferuar ai formim që vlerëson përvojën e mbështetjes në këndvështrimin e një zhvillimi të vazhdueshëm, ndoshta me ndihmën e pozitave/roleve të sistemit, të tilla si konsulentë psiko-pedagogjik, pedagogë dhe koordinatorë, më tepër se një trajnim aty për aty me ndërhyrje individuale dhe sporadike trajnimi, edhe pse me shumë cilësi. Mendimi për edukatoret është për t'u mbështetur dhe nga ajo që pohohet edhe në studimet më aktuale për mbështetjen e profesionalizmit të edukatoreve në shërbimet për fëmijërinë e hershme, në të cilën theksohet se, për sa është e mundur, të identifikohen format e ndryshme të kualifikimit, trajnimit. "Një politikë koherente dhe e larmishme, që synon zhvillimin e vazhdueshëm profesional në nivel institucional apo të ekipit, e hartuar nga stafi i specializuar (koordinatorët pedagogjikë, pedagogët, këshilltarët) mund të jepë efekte të dobishme për t'u barazuar me ato të përgatitjes fillestare profesionale. Megjithatë, kurset afatshkurtra gjatë shërbimit (p.sh. kurse të kufizuara për disa ditë në vit) që nuk përputhen me një politikë koherente nuk mjaftojnë për t'i rritur kompetencat e profesionistëve me kualifikim të ulët ose pa kualifikim."(Raporti Core, 2011:27).

Sa i përket besimit se të qenit prind të bën më të mirë në punën që kryen (b) (në këtë rast, subjektet janë pyetur për të treguar shkallën e tyre të pajtimit / mospajtimit me 4 pohimet) paraqesim ekskluzivisht mesataren e pyetjeve të vetme (Tab. 10), pasi analiza e komponentëve të veçantë nuk ka paraqitur rezultate veçanërisht të rëndësishme. Sikurse mund të vihet re, pikët mesatare tregojnë se subjektet janë më shumë se të pajtimit se e konsiderojnë të duhur përvojën e të qenit prind për zhvillimin e

profesionit të edukatorit/es, edhe pse shpesh problemet e sjelljes së fëmijëve të tyre mund të ndikojnë me performancën në punën e tyre[7].

Përvoja e të qenit nënë ndihmon në të kuptuarin më të mirë të nevojave dhe kërkesave, si të fëmijëve ashtu edhe të prindërve të tyre, sepse i kanë provuar vetë në planin personal, dhe siguron një bagazh eksperience si në planin praktik dhe në atë emocional, të rëndësishëm për ta zhvilluar një profesion që perceptohet në vazhdimësi me punën edukuese dhe të kujdesit shtëpiak.

Tab. 10 Besimi se të qenit prind ndihmon për ta kryer punën e tyre: Mesatarja dhe devijimet

Besimi se të qenit prind ndihmon për të kryer punën e tyre:	Nr.	Mesatarja	Devij. Stand.
Edukatorja që është edhe nënë i kupton më shumë kërkesat e fëmijëve dhe të prindërve të tjerë	231	3.46	.863
Për të punuar mirë edukatorja duhet të ketë provuar se si është të jesh nënë	231	3.40	.843
Të kesh fëmijë ndihmon vetëm në lidhje me disa aspekte praktike (dallimi i sëmundjeve, ndërrimi i pelenave,...)	230	3.22	.909
Shpesh problemi i sjelljes me fëmijët ndikon në performancën në punë	230	3.07	.910

Ushtrimi i profesionit

Brenda seksionit "Ushtrimi i Profesionit" edukatoreve iu kërkua të shënojnë shkallën e rëndësisë [8] që ua atribuon një serie objektivash, që mund të vendosen gjatë zhvillimit të profesionit të tyre. Analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) ka paraqitur 4 dimensione: objektivat e konsideruara si më të rëndësishme janë ato të dimensionit "Higjienë dhe pastërti" të fëmijëve, shpesh të arritshme dhe falë edhe bashkëpunimit me koleget; i dyti në radhën e rëndësisë është dimensioni "Siguria dhe organizimi i jetës së përditshme". Ky dimension i fundit ka të bëjë me praktika të përditshme që favorizojnë sigurinë dhe zhvillimin e fëmijës. Më pas, vijnë objektivat që përfshihen në dimensionin që kemi përkufizuar "kognitive/social", ose faktin që me fëmijët duhen arritur kompetenca të caktuara si kognitive dhe relacionale (të krijimit të raporteve, lidhjeve). Së fundi, por me pikë mjaft të larta, kemi dimensionin e përkufizuar "Autonomia dhe bindja" që vë në dukje dy terma të papajtueshme, duke sugjeruar se fëmija mund të bëhet i pavarur vetëm brenda një kornize konteksti të kontrolluar fort nga të rriturit.

Tab. 11 lejon të përshkruhet në terma të gjerë mendimi që edukatoret kanë për fëmijët dhe kujdestarët e tyre. Së pari, paraqitet dimensioni institucional i shërbimit: fëmija është nxënësi, subjekti në nevojë për kujdes dhe siguri, edukim nëpërmjet një konteksti të strukturuar fuqishëm dhe të organizuar. Ndoshta ky fakt lidhet me traditën e fortë shëndetësore, në fushën e formimit profesional të edukatoreve të fëmijërisë së hershme, që përtej hapave specifikë të studimit, ende karakterizon në mënyrë të rëndësishme kulturën e institucioneve edukative.

Jo rastësisht, higjiena dhe pastërtia paraqesin dy faktorë që duket se ndikojnë në cilësinë e shërbimit, e pasuar nga bashkëpunimi me koleget që, e vendosur në atë dimension, duket se sugjeron një koordinim të orientuar më shumë në zhvillimin e saktë të aktiviteteve sesa bashkëpunimit për arritjen e qëllimeve edukative specifike. Në fakt, dimensioni i dytë, ai që e kemi përkufizuar "siguria dhe organizimi i jetës së përditshme", paraqitet në vazhdimësi me të parin dhe mbledh të dhëna që paraqesin edhe një herë një organizim, që iu lejon të gjithëve të zhvillojnë në mënyrë të rregulltë, në siguri dhe në mënyrë të qetë aktivitetet e ditës.

7 1=aspak dakord, 2=pak dakord, 3=mjaft dakord, 4=shumë dakord

8 Shkallë me 4 pikë nga 1=aspak e rëndësishme deri në 4=shumë e rëndësishme

Dimensioni kognitiv dhe ai i autonomisë i ndjekin të dyja analizat; është interesante të vësh re, në këtë dimension të fundit, pozicionimin e bashkëpunimit me prindërit. Treguesi mund të sugjerojë që nëse edukatoret munden brenda kopshtit, të punojnë për të përftuar sjellje të sakta dhe të përshtatshme në jetën në komunitet, për arritjen e objektivave edukative më specifike (si ato sociale dhe kognitive), bashkëpunimi me familjen bëhet më domethënës dhe i rëndësishëm.

Është interesante të vësh re, se si autonomia është një nga elementet, që i jepet më pak rëndësi në krahasim me të mëparshmit, ndërkohë që zë vendin e parë të kompetencave që karakterizojnë fëmijët që frekuentojnë shërbimet, në krahasim me ata që nuk frekuentojnë. Si të thuash, është vetë-frekuentim i shërbimeve, që i bën fëmijët të jenë autonom, të pavarur, edhe pa qenë ky një nga objektivat prioritare të edukatoreve; autonomia është këtu sinonim i "të dish të bësh vetë" që mund ta zbehë pozitën, në dimensionin që e kemi quajtur "mundësitë" dhe të përfaqësojë një lloj fije të kuqe, që e lidh me dimensionin e "privimit". Lidhur me temat e kategorizuara te "Prindërit" dhe "privimi", mund të vëzhgojmë se janë ato që i shohin edukatoret në mospajtim të madh (Dev. Sta 0.73 dhe 0.79), dhe që përshkruajnë një situatë, në të cilën nuk ka harmoni të plotë lidhur me vizionin e parashkollorit për fëmijët nga 0 deri në 3 vjeç, si mundësi edukative e vlefshme për të gjithë fëmijët.

Tab. 11 Rëndësia e objektivave. Mesatarja dhe devijimet standarde.

Rëndësia e objektivave	Nr.	Mesatarja	Devij. Stand.
HIGJIENA DHE PASTËRTIA	**227**	**3.83**	**.39**
Pastërtia dhe higjiena e fëmijëve	228	3.85	.438
Bashkëpunimi aktiv me koleget	228	3.82	.438
SIGURIA DHE ORGANIZIMI I JETËS SË PËRDITSHME	**224**	**3.69**	**.47**
T'i mësosh fëmijët se si të sillen	228	3.80	.497
Siguria dhe qetësia personale e fëmijëve	226	3.67	.610
Realizimi i një projekti kulturor që lidhet me edukimin e fëmijëve	229	3.67	.603
Organizimi i rregullt i jetës së përditshme	230	3.63	.640
KOGNITIVE/SOCIALE	**226**	**3.63**	**.50**
Përvetësimi i aftësisë së bashkëpunimit ndërmjet fëmijëve	229	3.73	.525
Bashkëpunimi i prindërve	228	3.68	.586
Stimulimi te fëmijët me aftësi kognitive dhe linguistike	229	3.64	.637
Lidhja me strukturat e tjera edukative (shkolla)	230	3.48	.665
AUTONOMIA DHE BINDJA	**224**	**3.60**	**.59**
Bindja dhe edukimi i fëmijëve	227	3.65	.615
Autonomia e fëmijëve	227	3.55	.723

Në tërësi, me pyetjen në analizë janë pyetur edukatoret për të treguar shkallën e tyre të pajtimit/mospajtimit[9] lidhur me disa pohime, që vendosnin përballë njëra-tjetrës karakteristikat e fëmijëve që frekuentojnë shërbimet për fëmijët me ato të fëmijëve që nuk i frekuentojnë (Tab. 12). "Mundësitë", përbëhet nga pyetje që nënvizojnë se fëmijët që ndjekin shërbimet 0-6 vjeç vendosen në një kontekst që ofron kushte të favorshme për një zhvillim më të hershëm të tyre; "Karakteristikat e Institucionit", përbëhet nga pohime që pranojnë se shërbimet janë përcaktuar të jenë "të përshtatshme për fëmijët";

9 1=aspak dakord, 2=pak dakord, 3=mjaft dakord, 4=shumë dakord

dimensioni i tretë i referohet disa karakteristikave të "Prindërve" të fëmijëve që i frekuentojnë shërbimet, duke i kushtuar vëmendje nevojës nga ana e këtyre të fundit për ta kalibruar sjelljen e tyre ndaj situatës; "Privimi", përmban çështje që përshkruajnë institucionet si kontekst privimi.

Duke parë pikët mesatare, të marra në të 4 dimensionet, mund të pohojmë se subjektet pajtohen për të pranuar potencialet e institucioneve ("Mundësi" dhe "Karakteristikat e Institucionit" kanë mesatare mjaft të larta ndaj të tjerave, ndërsa "Privimi" paraqet një mesatare të ulët).

Sa i përket figurës prindërore, edukatoret pranojnë faktin se prindërit tentojnë ta rikuperojnë lidhjen e tyre me fëmijët, duke shfrytëzuar në mënyrë të konsiderueshme kohën që atyre iu mbetet në dispozicion ("Prindërit").

Tab. 12 Karakteristikat nga perspektiva e prindërve/edukatoreve e fëmijëve, që frekuentojnë shërbimet në lidhje me ata që nuk i frekuentojnë. Mesatarja dhe devijimet standarde.

Fëmijët që frekuentojnë shërbimet në lidhje me ata që nuk i frekuentojnë...	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
MUNDËSITË	**219**	**3.45**	**.50**
Kanë më shumë raste për të ndërtuar raporte domethënëse me bashkëmoshatarët	230	3.59	.605
Mësojnë më parë se të tjerët për t'i respektuar rregullat	227	3.47	.673
Bëhen më herët autonom, të pavarur	222	3.44	.733
Vendosin raporte afektive edhe me të rritur të tjerë	228	3.32	.725
KARAKTERISTIKAT E INSTITUCIONIT	**228**	**3.35**	**.66**
Janë më shumë të stimuluar në ana intelektuale	229	3.48	.717
Kanë në dispozicion hapësira të brendshme dhe të jashtme më të përshtatshme për kërkesat e tyre	229	3.21	.816
PRINDËRIT	224	2.72	.79
Kanë prindër më të disponuar në orët që kalojnë me ta	227	2.81	.883
Kalojnë shumë pak kohë me prindërit	226	2.62	.946
PRIVIMI	**215**	**2.56**	**.73**
Kalojnë pjesën më të madhe të kohës në një ambient artificial dhe pak stimulues	228	2.45	1.042
Bëhen më prepotentë dhe agresivë	226	2.23	1.034
Janë të detyruar ta përshtatin personalitetin e tyre me rregullat e jetës në grup	228	2.94	.998
Nuk kanë mundur të kalojnë në shtëpinë e tyre vitet më të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit	222	2.61	1.070

Kënaqshmëria e edukatorit/es

Në seksionin pasues të pyetësorit është hulumtuar niveli i kënaqshmërisë[10] së edukatoreve si ndaj profesionit ashtu edhe ndaj raporteve sociale, që duhet të ndërthuren gjatë zhvillimit të punës. Konsideruam të rëndësishme të nxirrnim në pah këtë të dhënë për të kuptuar imazhin që edukatoret kanë në lidhje

10 Në këtë seksion, subjektet u pyetën për të shprehur shkallën e tyre të kënaqshmërisë përmes një shkalle me 4 pikë (1=aspak i kënaqur, 2=pak i kënaqur,3=mjaft i kënaqur dhe 4=shumë i kënaqur).

me profesionin e tyre, duke analizuar burimet e kënaqshmërisë/mos kënaqshmërisë. Temat paraqisnin aspekte të ndryshme të punës, disa me karakter strukturor dhe të tjera më shumë të lidhura me marrëdhëniet e të tjerëve me faktorë institucionalë.

Ndaj kemi analizuar: kontekstin fizik në të cilin zhvillohet puna (ambienti) dhe kontekstin e krijimit të marrëdhënieve (raporti me të rriturit: kolegë dhe prindër); aspektet e brendshme (puna me fëmijët, varieteti i punës, autonomia, mundësia e rritjes profesionale); aspektet e jashtme (paga, orari i punës, qëndrueshmëria e vendit të punës); imazhi i jashtëm i institucionit parashkollor (administrata, prindërit).

Lidhur me elementët e kënaqshmërisë individuale (Tab. 13), analiza e komponentëve kryesorë nuk ka paraqitur rezultate të denja për shënim; elementet me më shumë kënaqshmëri duket se lidhen me faktin që puna e edukatorit/es është një profesion mjaft kreativ dhe që lejon hapësira të gjera autonomie për atë që e ushtron, përveç faktit që është një punë "e sigurt" që lejon një lloj "qëndrueshmërie". Të vetmet pikë që na afrojnë me shkallën "pak kënaqshmëri" janë ato që lidhen me çështjet "*Paga*" dhe "*Njohja nga ana e komunitetit (nga komuna)*" që tregon se shpesh subjektet ndjejnë që komuniteti nuk njeh siç duhet rëndësinë e punës që ata kryejnë, njohje kjo e munguar, çka pasqyrohet te pakënaqshmëria lidhur me kompensimin ekonomik.

Tab. 13 Elementet e kënaqshmërisë së punës së edukatorit/es. Mesatarja dhe devijimet standarde.

Elementet e kënaqshmërisë së punës së edukatorit/es	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
Kryerja e një punë kreative	227	3.47	.660
Mundësia për ta zgjedhur lirisht mënyrën e punës	228	3.41	.755
Stabiliteti/siguria e vendit të punës	228	3.39	.803
Ndarja me grupin e punës e zgjedhjeve mësimore	228	3.36	.781
Orari i punës	228	3.29	.816
Pavarësia / autonomia e punës	228	3.28	.823
Ambienti fizik (hapësira dhe pajisjet)	230	3.18	.856
Njohja nga ana e drejtoreshës e aktivitetit mësimor dhe didaktik	228	3.18	.988
Mundësia për karrierë	229	3.03	.964
Kryerja e një pune që nuk përsëritet	226	2.99	.914
Mundësia e inovacionit didaktik	224	2.96	.862
Koha e lirë	228	2.84	.978
Njohja nga ana e komunitetit (komunës)	226	2.75	1.089
Paga	223	2.32	1.095

Sai përket kënaqshmërisë, që lidhet me raportet sociale, që edukatori/ja duhet të krijojë gjatë zhvillimit të punës, analiza e komponentëve kryesore (rotacioni varimax) paraqet ekzistencën e 3 dimensioneve (Tab. 14): kënaqshmëria në raportet me "Kolegët", nënkuptohet për edukatoret e tjera; "Personeli tjetër, eprorët dhe shërbime të tjera". Pra, të gjithë bashkëpunëtorët me përjashtim të edukatoreve, si dhe "Palët" (prindërit dhe fëmijët).

Në përgjithësi, subjektet thonë se janë mjaft të kënaqur për të tri dimensionet e paraqitura edhe pse e papritur që kënaqëshmëria në raport me fëmijët merr pikë relativisht të ulëta. Të bën të reflektosh dhe fakti se mesataret më të ulëta i janë dhënë asistentes për fëmijët me aftësi të kufizuara (3.24), me shër-

bimet e tjera (3.26) dhe me prindërit (3.28), ose me të gjithë ata akterë, me të cilët edukatoret duhet të bashkëpunojnë, pikërisht në prani të problematikave specifike të fëmijëve. Për shkak të pranisë shumë të limituar brenda institucionit parashkollor të fëmijëve, që paraqesin nevoja specifike (nevoja të veçanta, fëmijët e komuniteteve RAE, ose fëmijët me një prapavijë socio-ekonomike, veçanërisht të varfër - të dhënat MASHT, 2011), duket i rëndësishme investimi në këtë sektor, si në mbështetje ashtu edhe në krijimin e mundësive për komunikim ndërmjet sektorëve të ndryshëm (shkollor, social dhe shëndetësor), si edhe për dokumentimin dhe komunikimin me familjet.

Tab. 14 Niveli i kënaqshmërisë në raportet sociale. Mesatarja dhe devijimi standard (shkalla 1 deri 4)

Niveli i kënaqshmërisë në raportet sociale	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
KOLEGËT	**197**	**3.47**	**.56**
Me kolegët në planin e marrëdhënieve personale	228	3.56	.602
Me kolegët në planin e raporteve profesionale (planifikimi mësimor, didaktik, drejtimi i institucionit parashkollor....)	229	3.55	.624
Me asistenten për fëmijët me aftësi të kufizuar	201	3.24	.897
PERSONELI TJETËR, EPRORËT DHE SHËRBIME TË TJERA	**222**	**3.43**	**.60**
Me të gjithë personelin	229	3.53	.666
Me drejtoreshën e institucionit	230	3.52	.757
Me drejtoreshën e aktivitetit mësimor dhe didaktik	228	3.41	.736
Me shërbimet e tjera (shëndetësore, pediatrike,...)	227	3.26	.897
PALËT	**220**	**3.41**	**.53**
Me fëmijët sipas aftësisë së tyre për të nxënë	224	3.50	.552
Me fëmijët në planin e raportit personal	225	3.48	.655
Me prindërit	225	3.28	.729

Qëllimi i grupeve me fëmijët e moshës 0-3 vjeçare

Ky sektor i pyetësorit përqendrohet në perceptimet që edukatoret kanë lidhur me qëllimin e klasave të kopshteve, të destinuara për fëmijët më të vegjël. Të anketuarit u pyetën për ta graduar nivelin e tyre të pajtimit / mospajtimit për një shkallë nga 1 në 4. Analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) tregoi ekzistencën e 4 dimensioneve (Tabela 15). Dimensioni që e kemi quajtur "Mundësitë dhe Burimet" i referohet një konceptimi të kopshtit, si një ambient të zhvillimit dhe përfshin çështjet që karakterizojnë kopshtin si një vend, ku fëmija ka një shans më të mirë për të zhvilluar aftësitë e tij në mënyrë të pasur dhe të ekuilibruar. Brenda kësaj pikëpamjeje paraqitet imazhi i fëmijës si një subjekt kompleks për nga karakteristikat e tij psikologjike, sociale dhe emocionale, dhe sjell idenë e një edukatori/e kompetent/e, të formuar në një mënyrë të veçantë. Dimensioni i dytë, "Institucionalizimi i fëmijëve," paraqet një ide të kopshtit që gjen konotacion me shërbimin që vazhdon në komunitet: kujdesi i fëmijëve në njërën anë dhe promovimi në anën kulturore, i praktikave të një rritjeje të duhur. Institucioni parashkollor rezulton të jetë një vend në të cilin mirëpritet një grup fëmijësh "në nevojë", të disavantazhuar në planin social dhe kulturor, ku edukatorja mbështetet mbi të gjitha te kompetencat e saj prej kujdestareje.

Në dimensionin e tretë, atë që e kemi përkufizuar "nevoja sociale dhe e kujdesit", zbehet qëllimi prej kujdestari dhe kemi një konceptim të kopshtit si një përgjigje në komunitet ndaj nevojës së prindërve

për të gjetur një vend të sigurt dhe personel të besuar, në momentin kur nuk është e mundur të siguro-het një kujdes i drejtpërdrejtë për fëmijën. Edukatori/ja, për të kryer sa më mirë punën, nuk i nevojitet një formim profesional specifik.

Së fundi, dimensioni i fundit, "*Imazhi negativ - privimi*" grupon ide që e paraqesin institucionin parashkollor që merr një vlerë disi negative: një institucion parashkollor i cili duhet të garantojë që fëmija është në një vend të sigurt, por që cenohet për shkak të një ambienti privues. Këtu fëmija është një subjekt i privuar nga mbështetja dhe dashuria e të dashurve të tij për një kohë të gjatë, dhe që e kalon këtë kohë në një ambient jo veçanërisht stimulues, këtu fëmija mund të përshtatet më lehtë, sa më herët që të fillojë me frekuentimin.

Është si të si të thuash: "meqenëse duhet të qëndrojë këtu është mirë të mësohet sa më parë që është e mundur". Në këtë rast, mjafton që edukatorja të bazohet në kompetencat e saj personale, duke pasur një qasje prej nëne, e aftë për t'ia larguar fëmijës çdo pasiguri që mund të ndjejë.

Është e rëndësishme që këto imazhe të institucionit parashkollor dhe edukatoreve të vazhdojnë të qëndrojnë dhe të bashkëjetojnë në të njëjtat struktura përballë situatave në të cilat kërkesat dhe nevojat po ndryshojnë shumë shpejt, duke integruar brenda institucionit kurse trajnimi që do t'iu mundësojnë edukatoreve të reja të mendojnë vetë për planifikimin e tyre edukativ në një sektor me ristrukturim kaq të fortë. Duket se qëndrojnë në mënyrë ambivalente, dy imazhe të institucionit parashkollor për fëmijët në krahasim me njëri-tjetrin: njëra më shumë e formës tradicionale, lidhur me nevojat e familjeve dhe me një sistem kujdestarie dhe një tjetër më inovative, në të cilin komuniteti dhe fëmijët gjenden në mesin e një planifikimi të përgjithshëm dhe të një ndërveprimi të plotë.

Tab. 15 Qëllimi i grupeve të moshës 0-3. Mesatarja dhe devijimet standard (shkalla nga 1 deri në 4)

Qëllimi i grupeve 0-3	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
MUNDËSITË, BURIMET	**221**	**3.62**	**.43**
Të dish t'i respektosh ritmet e fëmijëve, u kërkohet edukatoreve të kenë një njohuri të proceseve të zhvillimit të fëmijëve.	228	3.63	.576
Funksioni kryesor i këtyre institucioneve është ai i të qenit vendi i edukimit të fëmijëve	229	3.62	.576
Fëmija që ndjek grupin 0-3 vjeç ka mundësi më të mëdha për të pasur një zhvillim më të pasur dhe të ekuilibruar	222	3.59	.578
INSTITUCIONALIZIMI I FËMIJËVE	**227**	**3.57**	**.51**
Roli i edukatores është mbi të gjitha promovimi i një ndryshimi kulturor për sa i takon rritjes së fëmijës	227	3.62	.547
Klasat kanë kryesisht funksionin për ta garantuar një përkujdesje të sigurt për fëmijët, prindërit e të cilit janë në marrëdhënie pune	229	3.53	.672
NEVOJA SOCIALE/PËRKUJDESJA	**228**	**3.27**	**.58**
Të qenurit nënë dhe edukimi i fëmijëve janë realitete kolektive dhe sociale po aq sa private	229	3.31	.625
Çdo person të cilit i pëlqejnë fëmijët mund të jetë një edukatore e mirë	229	3.30	.874
Grupet e moshës 0-3 janë një domosdoshmëri për prindërit të cilët nuk kanë alternativa.	229	3.20	.919

IMAZHI NEGATIV - PRIVIMI[1]		216	2.96
Një nga aspektet më të rëndësishme të punës se edukatores është mbrojtja e shëndetit fizik të fëmijës	224	3.58	.659
Fëmija që ndjek këto klasa është në rrezik më të madh në krahasim me fëmijën që qëndron në shtëpi për të vuajtur nga mungesa e afeksionit	226	2.58	1.081
Regjistrimi i fëmijës në institucionin parashkollor është më efikas sa më herët që kryhet	228	3.37	.821
Grupet e moshës 0-3 janë mbi të gjitha një vend këmbimi kulturor dhe pjesëmarrjeje në një projekt të përbashkët gjatë fëmijërisë së hershme	229	3.36	.764
Për të qenë në gjendje për të vendosur raporte të qëndrueshme me të tjerët, fëmija ka nevojë të ketë pak raporte të qëndrueshme gjatë viteve të para të jetës	228	3.32	.780
Për të qenë edukatore e grupeve të moshës 0-3 është e mjaftueshme të bazohen në burimet personale	225	3.29	.861

Raporti me prindërit

Në pjesën e fundit të pyetësorit është hulumtuar në përgjithësi marrëdhënia ndërmjet prindërve dhe edukatoreve, dhe në veçanti perceptimet që edukatoret kanë për motivet që i kanë shtyrë prindërit për t'i regjistruar fëmijët në institucionin e destinuar për fëmijët e moshës 0-3 vjeçare dhe për kërkesat që ata më shpesh kanë ndaj institucionit parashkollor.

Së pari, na interesonte të kuptonim se cili ishte imazhi që edukatoret kishin në lidhje me nevojat e prindërve dhe nëse motivet që i kanë shtyrë për ta përdorur institucionin parashkollor janë më shumë me karakter edukativ ose të lidhura me nevojën subjektive dhe me mungesën e alternativave. Kjo e dhënë është e rëndësishme nëse mendojmë që vlera edukative e institucionit pas moshës 3 vjeçare është shumë e përhapur, ndërsa mbetet pak mosbesim në qasjen në institucione për fëmijët më të vegjël. Disa herë, janë vetë edukatoret që nuk besojnë plotësisht se zgjedhja e kopshtit është më e mira për interesin e fëmijës së vogël.

Në Tab. 16 paraqiten pikët mesatare të marra mbi temat e caktuara në përgjigjet ndaj pyetjes" "*Cilat janë sipas jush, arsyet e zgjedhjes së klasës për moshën 0-3 dhe të çerdhes, kopshtit nga ana e prindërve ?*".

Të gjitha motivimet kanë marrë pikë mjaft të larta, si ato që fokusohen në cilësinë edukuese dhe të përvojës që i ofrohet fëmijës, mbi të gjitha në perspektivën e socializimit, edhe ato që vënë në planin e parë anën e nevojës.

Kjo e dhënë duket se nxjerr në pah një kundërthënie mbi motivimet e frekuentimit të kopshtit nga ana e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç: si të thuash që ky institucion është një vend i sigurt dhe i kualifikuar për të lënë fëmijët nëse prindërit nuk mund të kujdesen drejtpërdrejt. Pra, një alternativë, e perceptuar si një mundësi, por rrallë si zgjedhje. Si mbështetje e interpretimit, i cili evidenton kundërthënien e edukatoreve në lidhje me motivacionet që kanë të bëjnë me zgjedhjen e prindërve, është vlera e lartë e devijimit standard, e cila i afrohet njësisë.

Tab. 16 Arsyet e zgjedhjes së klasave nga prindërit. Mesatarja dhe devijimi standard[11]

Arsyet e zgjedhjes	Nr	Mesatarja	Dev. Stand.
Ideja që mund ta lë fëmijën në një ambient të sigurt	228	3.68	.608
Pranimi i nevojës së socializimit të fëmijës	226	3.57	.665
Mundësia që institucioni u ofron prindërve një hapësirë përballjeje me problemet edukative	224	3.36	.769
Komoditeti i orarit	226	3.31	.762
Komoditeti logjistik (organizimi i jetës së përditshme)	226	3.24	.825
Bindja se në klasat e moshës 0-3 fëmija zhvillohet më shpejt	226	3.12	.855
Duke mos pasur zgjidhje të tjera	226	2.91	.945
Preferencë sesa t'ua besojnë fëmijën gjyshërve ose prindërve të tjerë	227	2.81	.916
Preferencë në vend që t'i besojnë një dadoje	224	2.81	.986

Të dhënat mund të lexohen në dy mënyra të ndryshme. Mund të supozohet së pari, se fakti që prindërit kërkojnë mbi të gjitha informacione, që lidhen me nevojat primare të fëmijës dhe me mirëqenien e tij në institucion, paraqet një model kopshti ende shumë të përqendruar në anën e kujdestarisë, ku ndjekja e zhvillimit të kompetencave specifike, veçanërisht me natyrë kognitive, gjen pak vend. Nga ana tjetër, është që prindërit ua atribuojnë kujdesin, mbështetjen dhe lidhjen me fëmijët, si detyrë prioritare institucionit parashkollor. Si të thuash, vetëm përgatitja e një konteksti të sigurt dhe ku krijohet një marrëdhënie me fëmijën, garanton cilësinë e përvojës së fëmijës në institucionin parashkollor, që përfaqëson një kusht thelbësor për zhvillimin e fëmijës.

Edhe në këtë rast, vlera tjetër e Devijimit Standard (DS) sugjeron një situatë ambivalente, ku ana e kujdesit merr karakteristika që lidhen më shumë me sigurinë dhe zhvillimin e aktiviteteve të përgjithshme sesa me mirëqenien e tij të përgjithshme.

Pyetja tjetër u kërkonte edukatoreve të tregonin, sipas tyre, sa shpesh ndeshen në vështirësi prindërit e nxënësve të tyre[12].

Në përgjithësi, kritika që edukatoret ia atribuojnë prindërve, i përket bindjes se janë të vetmit që mund ta kuptojnë fëmijën e tyre, orari i hapjes së institucionit parashkollor, largësia e institucionit parashkollor nga shtëpia ose vendi i punës, vështirësia për t'u ndarë nga fëmija kur e lënë në institucionin parashkollor. Analiza e të dhënave të grupuara në tab. 18 duket se sugjeron se vështirësia me të cilën ndeshen edukatoret, në lidhje me prindërit, lidhet me faktin se këta të fundit tentojnë të mos e njohin ende plotësisht vlerën edukative të kopshtit dhe profesionin specifik të atyre që punojnë. Edukatoret kërkojnë, në raportin profesional me prindërit, një njohje që nuk ndodh nëse ata perceptojnë që prindërit nuk besojnë plotësisht në kompetencat e tyre për t'i kuptuar fëmijët, për t'u kujdesur për ta, në programin edukativ të institucionit parashkollor. Edukatoret japin pikët më të ulëta në temat, ku vështirësia e lidhjes i përket sferës emocionale, në rivalitetin ndërmjet figurave referuese për fëmijën dhe xhelozisë në lidhje me këtë të fundit (të ndjerit më pak të aftë, xhelozia ndaj edukatoreve).

Në tabelën 17 tregohen rezultatet e marra pas përgjigjes së pyetjes "Çfarë informatash i kërkojnë prindërit mbi fëmijën e tyre personelit të institucionit parashkollor". Me këtë pyetje donim të hulumtonim me çfarë termash diskutojnë për fëmijën edukatoret dhe prindërit, në lidhje me cilat nevoja përballen më shumë.

11 Shkalla me 4 pikë(1=kurrë/thuajse kurrë, 2=ndonjëherë, 3=shpesh dhe 4=shumë shpesh).

12 Analiza e komponentëve kryesore nuk ka paraqitur rezultate me vlerë për t'u shënuar.

Analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) nxjerr në pah 3 dimensione: "Fëmija" biologjik", që fokusohet në nevojat bazë (vakti, gjumi, jashtëqitja) që duket se përbëjnë informacionin kryesor të kërkuar nga prindërit, "Fëmija social", që ka të bëjë me atë që prindërit pyesin se si fëmija ka ndërvepruar me bashkëmoshatarët dhe edukatoret dhe së fundi, jo shpesh e kërkuar "Fëmija i fëmijës nxënës", që ka të bëjë me pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitetet didaktike të propozuara nga struktura dhe qëndrimi ndaj tyre.

Tab. 17 Informacioni që kërkohet nga prindërit. Mesatarja dhe devijimi standard[13]

Informacion i kërkuar nga prindërit	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
FËMIJA/ZHVILLIMI BIOLOGJIK	216	3.30	.63
Nëse po, kur dhe çfarë ka ngrënë	228	3.47	.742
Kur ka fjetur	223	3.40	.734
Kur ka kryer jashtëqitjen	224	3.04	.885
FËMIJA/ZHVILLIMI SOCIAL	217	2.94	.78
Si është sjellë me edukatoret	228	2.88	.961
Çfarë lojërash ka luajtur	221	2.85	.934
Si është sjellë me bashkëmoshatarët	227	3.06	.870
Çfarë humori ka pasur	226	3.00	.945
FËMIJA/ZHVILLIMI NXËNËS	226	2.88	.78
Sjellje të veçanta (të qarat, agresiviteti)	227	2.90	.973
Progresi në përfitimin e aftësive specifike	228	2.88	.900
Kur ka marrë pjesë në propozimet edukative	229	2.87	.982

Të dhënat mund të lexohen në dy mënyra të ndryshme. Mund të supozohet së pari, se fakti që prindërit kërkojnë mbi të gjitha informacione, që lidhen me nevojat primare të fëmijës dhe me mirëqenien e tij në institucion, paraqet një model kopshti ende shumë të përqendruar në anën e kujdestarisë, ku ndjekja e zhvillimit të kompetencave specifike, veçanërisht me natyrë kognitive, gjen pak vend. Nga ana tjetër, është që prindërit ua atribuojnë kujdesin, mbështetjen dhe lidhjen me fëmijët, si detyrë prioritare institucionit parashkollor. Si të thuash, vetëm përgatitja e një konteksti të sigurt dhe ku krijohet një marrëdhënie me fëmijën, garanton cilësinë e përvojës së fëmijës në institucionin parashkollor, që përfaqëson një kusht thelbësor për zhvillimin e fëmijës.

Edhe në këtë rast, vlera tjetër e Devijimit Standard (DS) sugjeron një situatë ambivalente, ku ana e kujdesit merr karakteristika që lidhen më shumë me sigurinë dhe zhvillimin e aktiviteteve të përgjithshme sesa me mirëqenien e tij të përgjithshme.

Pyetja tjetër u kërkonte edukatoreve të tregonin, sipas tyre, sa shpesh ndeshen në vështirësi prindërit e nxënësve të tyre[14].

Në përgjithësi, kritika që edukatoret ia atribuojnë prindërve, i përket bindjes se janë të vetmit që mund ta kuptojnë fëmijën e tyre, orari i hapjes së institucionit parashkollor, largësia e institucionit parashkollor nga shtëpia ose vendi i punës, vështirësia për t'u ndarë nga fëmija kur e lënë në institucionin parashkollor. Analiza e të dhënave të grupuara në tab. 18 duket se sugjeron se vështirësia me të cilën ndeshen edukatoret, në lidhje me prindërit, lidhet me faktin se këta të fundit tentojnë të mos e

13 Shkalla me 4 pikë(1=kurrë/thuajse kurrë, 2=ndonjëherë, 3=shpesh dhe 4=shumë shpesh).

14 Analiza e komponentëve kryesore nuk ka paraqitur rezultate me vlerë për t'u shënuar.

njohin ende plotësisht vlerën edukative të kopshtit dhe profesionin specifik të atyre që punojnë. Edukatoret kërkojnë, në raportin profesional me prindërit, një njohje që nuk ndodh nëse ata perceptojnë që prindërit nuk besojnë plotësisht në kompetencat e tyre për t'i kuptuar fëmijët, për t'u kujdesur për ta, në programin edukativ të institucionit parashkollor. Edukatoret japin pikët më të ulëta në temat, ku vështirësia e lidhjes i përket sferës emocionale, në rivalitetin ndërmjet figurave referuese për fëmijën dhe xhelozisë në lidhje me këtë të fundit (të ndjerit më pak të aftë, xhelozia ndaj edukatoreve).

Tab. 18 Vështirësitë e raportit me prindërit. Mesatarja dhe devijimet standarde[15]

Këtu paraqiten disa vështirësi, me të cilat ndeshen prindërit që sjellin fëmijët në institucionin parashkollor 0-6. Në bazë të përvojës tuaj tregoni sa shpesh janë paraqitur	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
Bindja se jeni të vetmit të aftë për ta kuptuar fëmijën	227	2.95	.967
Orari i hapjes së institucionit parashkollor	224	2.93	.918
Se duhet të ndahesh nga fëmija për një pjesë të ditës	226	2.90	.791
Largësia nga shtëpia ose nga vendi i punës	223	2.70	.947
Frika se mos fëmijës i ngjiten sëmundje	228	2.65	.975
Frika se mos fëmija vuan	229	2.60	.962
Të mos qenit plotësisht të bindur për vlerën edukative të institucionit parashkollor	228	2.43	1.028
Sjellja e ndryshme krahasuar me shkollat e familjarëve të tjerë	222	2.42	1.042
Të ndjerit më pak të aftë se edukatoret	223	2.33	1.089
Frika se mos fëmija lidhet ekskluzivisht me edukatoret	227	2.26	1.103
Besimi i dobët te personeli	227	2.25	1.062

Së fundi, pyetjes "*A konsideron se në përgjithësi prindërit, të cilët i sjellin fëmijët në institucionin parashkollor janë të kënaqur me zgjedhjen?*" edukatoret përgjigjen të bindur që prindërit janë shumë të kënaqur (Tab. 18)[16], duke treguar një prevalencë pozitive të punës së tyre nga ana e familjeve.

Tab. 19 Kënaqshmëria e përgjithshme e prindërve. Mesatarja dhe devijimi standard

Kënaqshmëria e përgjithshme e prindërve	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
13	225	3.99	,79

Ndikimi i moshës mbi përvojën profesionale të edukatores

Sa i përket të dhënës fillestare, që lidhet me moshën e edukatoreve të intervistuar, u duk interesante të hulumtohet nëse kishte ndonjë korrelacion ndërmjet perceptimeve, që edukatoret kanë për veten e tyre, me fëmijët dhe me profesionin e tyre, si dhe me moshën e tyre profesionale. Kjo paraqet një të dhënë më domethënëse sa i përket asaj të moshës fizike, e lidhur kjo, edhe me historinë e fundit të vendit. Lufta, në fakt, sigurisht ka ndikuar në rrjedhën profesionale të banorëve të Kosovës, duke i bërë më pak lineare karrierat e edukatoreve, qëndrimin e tyre në një institucion parashkollor.

15 Shkalla me 4 pikë(1=kurrë/thuajse kurrë, 2=ndonjëherë, 3=shpesh dhe 4=shumë shpesh).

16 Në lidhje më atë si ishte paraqitur në pyetësor, rezultatet e treguara në tabelë janë marrë duke përmbysur rendin e shkallës (me 5 pikë).vlera në tabelë duhet të kuptohet se është marrë sipas kodeve më poshtë: 1 = aspak, 2 = pak, 3 = deri diku, dhe 4 = shumë 5 = tepër.

Analiza e parë, na ka lejuar të evidentohet ekzistenca e korrelacionit negativ me dimensionet më poshtë për motivimet dhe zgjedhjet profesionale. Në veçanti, doli në pah se me shtimin e moshës profesionale zvogëlohen motivimet e lidhura me "Prirjen" (*r*= -.21[17]*) dhe ato të lidhura me "Vlera e edukimit ndërmjet traditës dhe inovacionit" (*r*= -.25**). Sa më shumë rritet mosha profesionale, aq më pak edukatoret perceptojnë si të rëndësishme për profesionalizmin e tyre funksionin social të punës së tyre. Vlera e edukimit, kënaqësia e të punuarit me fëmijët, kreativiteti janë faktorë, që me kalimin e kohës, dobësojnë forcën e tyre shtytëse. Të jesh edukatore, tenton të sigurojë më pak kënaqësi, si në planin e kënaqësive personale (prirjes) dhe në atë social: dobësohet forca për të ndërhyrë në institucionin parashkollor dhe në shoqëri, për të sjellë një ndryshim, për ta stimuluar inovacionin. Kompetencat profesionale nuk janë në mbështetje të motivimeve të edukimit. Në fakt, janë evidentuar korrelacione gjithnjë negative edhe me perceptimin e edukatores ideale: me rritjen e moshës në shërbim, zvogëlohet bindja se për të qenë një edukator i mirë duhet të zotërosh "Kompetenca pedagogjike/didaktike" (*r*= -.19**) dhe "Kompetenca organizative/menaxheriale" (*r*= -.16[18]).

Imazhi i edukatores profesionale të edukimit paraqitet këtu në humbje. Aftësitë pedagogjike-didaktike dhe ato organizative - menaxheriale priren, me kalimin e kohës, të vendosen në plan të dytë. Interpretimi i treguesit është i dyfishtë: nga njëra anë mund të mendohet se edukatoret, duke grumbulluar përvojë, zhvillojnë kompetencat e tyre pedagogjike dhe menaxheriale. Zotërimi i kompetencave teknike profesionale mund ta zvogëlojë rëndësinë e tyre në perceptimin e edukatorit/es ideal/e, duke sjellë në plan të parë kompetenca të tjera (si p.sh. ato të krijimit të marrëdhënieve). Një interpretim tjetër është ai për të cilin praktika profesionale tenton ta zvogëlojë idenë e edukatoreve se mund t'i përmbushin objektivat e shpresuara për punën e tyre dhe në prani të kompetencave profesionale specifike. Ky interpretim i dytë duket më koherent me kornizën e përgjithshme, që del nga të dhënat. Në fakt, korrelacione të tjera negative janë individualizuar edhe në lidhje me burimet, që edukatoret përdorin për ta ushtruar profesionin e tyre: sa më shumë rritet koha në shërbim, më pak edukatoret deklarojnë se për përgatitjen e tyre janë të rëndësishme "Trajnimet fillestare dhe gjatë punës" (*r*= -.20**) dhe "Trajnimi joformal (*r*= -.19**). Jo vetëm duken gjithnjë e më pak të rëndësishëm kompetencat profesionale, të fituara dhe të zhvilluara, por nuk ndjehet as nevoja për t'u trajnuar për të gjetur mjete inovative më efikase.

Nuk paraqiten korrelacione domethënëse midis moshës profesionale dhe objektivave të ndjekura gjatë ushtrimit të profesioni të tyre. Domethënës është fakti që paraqitet një korrelacion, këtë herë pozitiv, me dimensionin "Prindër" (*r*= -16**). Pra, me rritjen e moshës profesionale rritet edhe vëmendja ndaj raportit me prindërit dhe mbështetjes së prindërimit. Edukatoret duket se gjenden në aleancë me prindërit, veçanërisht me ata të fëmijëve më të vegjël, atë mbështetje në punën e tyre, të cilën nuk e gjejnë në planin institucional dhe social. Në fakt, midis përvojës profesionale dhe elementeve të kënaqshmërisë së punës së edukatorit/es, dalin shumë korrelacione domethënëse gjithnjë negative (Tab. 19).

Ndërmjet rezultateve, më shumë të dukshme për t'u shënuar, është që sa më shumë rritet përvoja profesionale, më shumë zvogëlohet kënaqësia, që edukatoret perceptojnë lidhur me pranimin që drejtoresha tregon ndaj tyre, për mundësinë e karrierës, e pagës, idesë së risisë në mjetet didaktike që përdorin, perceptimit të autonomisë në punë.

17 ** sig <.01

18 * sig <.05

Tab. 19 Korrelacionet(r nga Pearson) ndërmjet përvojës profesionale dhe Elementeve të kënaqësisë së punës së edukatoreve

Elementet e kënaqshmërisë së punës së edukatores	Nr	R
Njohja nga ana e drejtoreshës së aktiviteteve edukative-didaktike	208	-.28**
Mundësia e karrierës	209	-.28**
Paga	205	-.26**
Mundësia e inovacionit didaktik	204	-.24**
Pavarësia/autonomia në punë	208	-.24**
Kryerja e një pune jo të përsëritshme	206	-.23**
Stabiliteti/siguria e vendit të punës	208	-.21**
Kryerja e një pune kreative	207	-.20**
Koha e lirë	207	-.19**
Ambienti fizik (hapësira dhe pajisjet)	209	-.19**
Orari i punës	208	-.19**
Ndarja e grupit të punës dhe zgjedhjeve mësimore	207	-.18**
Njohja nga ana e komunitetit (komunës)	207	-.15*
Mundësia për ta zgjedhur lirisht mënyrën e punës	207	-.10

**sig <.01 *sig <.05

Edhe në planin e kënaqshmërisë së perceptuar në raportet sociale evidentohet se me rritjen e përvojës profesionale bie kënaqshmëria në lidhje me raportet me kolegët e tyre (*r*= -.29**). Interesant, fakti, se me rritjen e moshës së edukatoreve zvogëlohet edhe perceptimi i një institucioni parashkollor për fëmijët e moshës 0-3 si kontekst negativ dhe privues (*r*= -.15*), sikurse imazhi i kopshtit si parapërgatitor për hapat e mëtejshëm (*r*= -.16*). Kjo e dhënë, e përafruar me atë, që lidhet me atë që i kushton vëmendje aleancës me prindërit, të bën të mendosh për një vëmendje më të madhe dhe për një rëndësi më të madhe që i atribuohet edukatoreve, në planin e marrëdhënieve. Perceptimi i institucionit parashkollor ka tendencë të transformohet në kohë, duke kaluar nga një institucion, ku në vendin e parë është siguria nga njëra anë dhe zhvillimi i kompetencave dhe marrjes së aftësive në një vend, që i jep përparësi marrëdhënieve dhe dimensionit socio-afektiv.

Një nga faktorët që mund të ndikojë në këtë ndryshim është trajnimi, kualifikimi fillestar: mund të mendohet në fakt, se edukatoret që kanë një moshë profesionale më të madhe janë edhe ato, që zotërojnë kualifikime më pak të thella ose të specializuara. Andaj, edhe trajnimi ndikon në lidhje me atë, që përfaqëson dhe me kënaqshmëritë në lidhje me kontekstin e punës.

Ndryshimet sipas kualifikimeve shkollore

Me qëllimin për t'i paraqitur ndryshimet e mundshme lidhur me dimensionet e pyetësorit mbi bazën e kualifikimeve shkollore, kemi kryer një ANOVA (oneway) duke përballur tri grupet e subjekteve:

a) ato me kualifikimin e shkollës së mesme të mjekësisë (TSSM)
b) ato me kualifikimin e shkollës së mesme të përgjithshme (TSS)
c) ato me diplomën e Fakultetit të Pedagogjisë (në drejtimet pedagogji e përgjithshme ose edukimin inkluziv/special) ose të Fakultetit të Edukimit (drejtimi parashkollor ose fillor, përjashtohen drejtimet në lëndë specifike) (DIPLOMA).

Të vetmet ndryshime, që paraqiten i gjejmë te tematika "Motivimet për profesionin" në dimensionin "Vlera e edukimit midis traditës dhe inovacionit" dhe në tematikën "Informatat e kërkuara nga prindërit" në dimensionin "Fëmija biologjik".

Te "Vlera e edukimit ndërmjet traditës dhe inovacionit" edukatoret me shkollë të mesme kanë më pak pikë në krahasim me dy grupet e tjera (me shkollën e mesme të përgjithshme dhe me Diplomë) (mesatarja TSSM=3.28, mesatarja TSS=3.50, mesatarja DIPLOMA=3.50, F=2.79, Gdl=2-190, p≤.06[19]).

Në dimensionin "Zhvillimi biologjik", edukatoret që kishin kryer shkollën e mesme mjekësore paraqesin pikë shumë të larta në krahasim me dy grupet e tjera (shkolla e mesme e përgjithshme dhe Diploma) (mesatarja TSSM=3.44 mesatarja TSS=3.16, mesatarja DIPLOMA=3.27, F=3.14, Gdl=2-187, p≤.05).

Treguesi nuk është veçanërisht domethënës: edukatoret që kanë kryer një formim mjekësor i japin më shumë rëndësi kushteve higjienike në krahasim me koleget me një kualifikim më shumë të orientuar në planin psiko-pedagogjik, që mbështet vlerën e inovacionit dhe të ndryshimit.

Përfaqësitë e ndryshme të edukatoreve të shërbimeve publike (ESPub) dhe edukatoreve të shërbimeve private (ESPri)

Një tregues i fundit, që na intereson të analizojmë, është ai që lidhet me tipologjinë e drejtimit të shkollave.

Përmes analizimit të variantit (Oneway) u mundësia vendosja përballë e përgjigjeve të edukatoreve në shërbimet publike (ESPub) me ato të edukatoreve të shërbimeve private (ESPri), në të gjitha dimensionet me temat e mëposhtme, të hulumtuara në këtë pyetësor:

- Motivimet e zgjedhjes profesionale
- Edukatori/ja ideal/e
- Burimet e profesionalizmit
- Ushtrimi i profesionit
- Kënaqshmëria e edukimit
- Qëllimi i grupit me fëmijë të moshës 0-3 vjeçare
- Raporti me prindërit

Nuk paraqiten ndryshime statistikore domethënëse në dimensionet e fushës "Motivimet e zgjedhjes profesionale", "Edukatori/ja ideal/e" dhe "Burimet e profesionalizmit".

Brenda tematikës "Burimet e profesionalizmit" nuk paraqiten ndryshime mbi rëndësinë që ESPub dhe ESPri i atribuojnë objektivave, që lidhen me fëmijët. Ndërsa, për sa i takon perceptimit që edukatoret kanë për fëmijët e moshës 0-3, që frekuentojnë në krahasim me ata që nuk frekuentojnë, paraqitet një ndryshim në dimensionin që kemi përkufizuar "Privimi": ESPub-të konsiderojnë në masë më të madhe ndaj kolegëve të tyre të ESPri-t, që shërbimet pranë të cilave punojnë rrezikojnë të jenë për këtë grup moshe kontekste privuese (Mesatarja ESPub=2.60, mesatarja ESPriv=2.27, F=4.75, Gdl=1-214, p≤.03). Ky tregues ka nevojë të studiohet më shumë. Mund të supozojmë që investimi i sektorit privat në lidhje me këtë grup-moshë (0-3 vjeç) është më i madh në krahasim me atë publik: të dhënat statistikore paraqesin një nevojë të vendeve në institucionin parashkollor për fëmijët që janë në rritje të vazhdueshme, nevojë së cilës nuk i korrespondon një ofertë e përshtatshme publike. Investimi në cilësinë e ofertës mbi të gjitha për fëmijët e moshës nën tri vjeçare, duket si investim në një treg, i cili në të ardhmen mund të kthehet në një treg pune në zgjerim të vazhdueshëm. Perceptimi i të qenit brenda një sektori në evolucion mund të jetë dhe faktori që gjendet në bazën e numrit më të madh të ndryshimeve, që paraqiten ndërmjet dy tipologjive të edukatoreve. Këto evidentohen brenda tematikës "Kënaqshmëria e edukimit", si në dimensionin "Elementet e kënaqshmërisë së punës së edukatores" dhe në dimensionin "Niveli i kënaqshmërisë në raportet sociale", ku ESPriv-ët rezultojnë mesatarisht më të kënaqur se ESPub-ët.

19 me prirje të jetë domethënëse

Në tab. 20 paraqesim ndryshimet e paraqitura në pyetjet e parashikuara në "Elementet e kënaqshmërisë së punës së edukatores".

Tab. 20 Anova njëdrejtimëshe. Elementet e kënaqshmërisë së punës së edukatores. Dallimet ndërmjet ESPub dhe ESPriv.

Elementet e kënaqshmërisë së punës së edukatores	Mesatarja ESPub (N)	Mesatarja ESPriv (N)	F	gdl	P
Ambienti fizik (hapësira dhe pajisjet)	3.10 (203)	3.78 (27)	16.00	1-229	**.000**
Orari i punës	3.27 (201)	3.44 (27)	1.04	1-227	n.s.
Kryerja e një pune kreative	3.42 (200)	3.85 (27)	10.87	1-226	**.001**
Stabiliteti/sigurimi i vendit të punës	3.35 (201)	3.67 (27)	3.67	1-227	**.06***
Mundësia për ta zgjedhur lirisht mënyrën e punës	3.35 (203)	3.92 (25)	13.41	1-227	**.000**
Ndarja me grupin e punës së zgjedhjeve mësimore	3.30 (202)	3.81 (26)	10.04	1-227	**.002**
Njohja nga ana e komunitetit (nga komuna)	2.68 (201)	3.32 (25)	8.01	1-225	**.005**
Njohja nga ana e drejtoreshës për aktivitetet edukative dhe didaktike	3.10 (202)	3.77 (26)	10.90	1-227	**.001**
Paga	2.17 (196)	3.41 (27)	35.01	1-222	**.000**
Zgjedhja e një pune jo të përsëritur	2.90 (199)	3.67 (27)	18.01	1-225	**.000**
Mundësia e inovacionit didaktik	2.87 (198)	3.69 (26)	23.05	1-223	**.000**
Mundësia për karrierë	2.97 (202)	3.44 (27)	5.89	1-228	**.02**
Koha e lirë	2.78 (201)	3.26 (27)	5.81	1-227	**.02**
Pavarësia /autonomia në punë	3.22 (201)	3.67 (27)	7.08	1-227	**.008**

* me prirje të jetë domethënëse

Te "Niveli i kënaqshmërisë në raportet sociale", ESPriv deklarohen më të kënaqur se ESPub në raportin si me "Kolegët" (Mesatarja ESPub=3.43, mesatarja ESPriv=3.81, F=7.90, Gdl=1-196, p≤.005) si me "Personelin tjetër, eprorët dhe shërbimet e tjera" (Mesatarja ESPub=3.39, mesatarja ESPriv=3.71, F=6.60, Gdl=1-221, p≤.01).

Edhe në tematikën "Qëllimi i klasës së fëmijëve të moshës 0-3" shohim se ESPriv kanë mesatare më të larta se ESPub, veçanërisht në dimensionin "Mundësia dhe burimet" (Mesatarja ESPub=3.60, mesatarja ESPriv=3.77, F=3.66, Gdl=1-220, p≤.06[20]) dhe "Vizioni negativ- privues" (Mesatarja ESPub=2.94, mesatarja ESPriv=3.09, F=3.960, Gdl=1-215, p≤.05). Kontradikta e pjesshme e kësaj

20 me prirje të jetë domethënëse

të dhëne të fundit, me atë të paraqitur më parë për përfaqësimet e edukatoreve të klasave 0 deri në 3 vjeç, mund të jetë tregues i faktit, që institucioni parashkollor përfaqëson një zgjidhje kompensuese, për t'u përdorur vetëm nëse nuk praktikohen alternativa të tjera të kujdesit të fëmijëve. Në sektorin publik, ideja për t'iu përgjigjur një nevoje përmes një shërbimi publik, të komunitetit, ka tendencë për ta zbutur këtë perceptim negativ; në privat investohet për t'iu përgjigjur një nevoje përmes një oferte të tregut.

Në fund, te "Raporti me prindërit", ESPub paraqesin mesatare me të ulët, në krahasim me ESPriv, në dimensionin "Zhvillimi i fëmijës nxënës" (Mesatarja ESPub=2.85, mesatarja ESPriv=3.15, F=3.56, Gdl=1-225, p≤.06[21]): prindërit që i sjellin fëmijët në institucionet parashkollore private rezultojnë të jenë më të interesuar për rezultatet edukative të institucioneve parashkollore.

Ndryshimet mbi bazën e tipologjisë së shërbimit mbi qëllimin e klasave 0-3

Së fundi, kemi kërkuar të analizojmë dimensionet e ndryshme mbi temën e qëllimeve të grupeve 0-3 të ndërthurura në bazë të tipologjisë së shërbimit, të kryer nga edukatoret (çerdhja 0-3, kopshti 3-5, parashkollori 5-6). Nuk paraqiten ndryshime statistikore domethënëse: perceptimet e edukatoreve për klasat e destinuara fëmijëve më të vegjël nuk varet nga niveli shkollor, në të cilin punojnë. Kjo është një e dhënë në këndvështrimin tonë pozitiv, që evidenton mundësinë e një pune kolegjiale, dhënë vazhdimësi ndërmjet edukatoreve për gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kopshtit.

21 me prirje të jetë domethënëse

PËRFUNDIME

Një hyrje e shkurtër

Nuk duhet të harrojmë se të dhënat e grumbulluara sa i përket asaj që përfaqësojnë dhe përvojën profesionale të edukatoreve të intervistuara, nuk mund të lexohen në vazhdimësi, me të dhënat e mbledhura nga punë analoge, të kryera në vendet e tjera.

Historia e fundit e Kosovës, dhe në veçanti lufta, përbën një element të rëndësishëm, i cili është i vështirë të merret në konsideratë, dhe në mungesë të literaturës specifike. Nuk mund të mendojmë, që lufta nuk ka ndikuar në disa terma kyç, të paraqitur në këtë raport, si për shembull perceptimi lidhur me sigurinë e fëmijëve, në faktin që shkolla të paraqesë një vend të mbrojtur, të sigurt, të pastër, të perceptuar nga komuniteti, si vende të mbrojtura. Të dhënat e analizuara në formë të përmbledhur, nuk mund të zëvendësojnë historitë e atyre edukatoreve, të cilat kanë vazhduar të punojnë gjatë luftës, duke u përpjekur për ta ruajtur angazhimin e tyre ndaj fëmijëve, ndjeshmëria e tyre, inteligjenca dhe talenti. Ky lloj i kërkimit, i formës posaçërisht cilësore, do të ishte shumë i rëndësishëm për ta bërë të mundur rindërtimin e kontekstit për të bërë hulumtime të tjera mbi institucionin parashkollor dhe profesionin e edukatorit/es.

Në përgjithësi, pyetësori ka paraqitur një profil të përgjithshëm të edukatores, që punon në institucionin parashkollor. Edukatorja "tip" d.m.th. ajo më së shumti e paraqitur në mostër, është ajo e një gruaje të pjekur, të martuar dhe të paktën me dy fëmijë. Gjysma e mostrës së studiuar ka një diplomë të shkollës së lartë dhe gjysma tjetër një diplomë universitare, punon mesatarisht 16 vjet në sektorin publik dhe 6 vjet në atë privat. Kontekstet e punës janë shumë heterogjene, si në lidhje me numrin e fëmijëve me të cilët punojnë dhe me numrin e kolegeve, më të cilat bashkëveprojnë. Motivet që i kanë shtyrë edukatoret për të pasur një karrierë në këtë sektor janë më shpesh të brendshme sesa të jashtme. Kanë zgjedhur të japin mësim, sepse kanë menduar se do të bënin një punë dinamike dhe kreative dhe që do u jepte kënaqësi, veçanërisht në planin afektiv dhe të krijimit të marrëdhënieve, mbi të gjitha në kontaktin me fëmijët. Në vendin e dytë, profesioni i edukatorit/es paraqet një punë të njohur në nivelin social dhe perceptohet fillimisht si motori i inovacionit dhe ndryshimit social. Edukatorja ideale është ajo që i përgjigjet komunitetit dhe te e cila predominon funksioni social ndaj atij të promotorit të zhvillimit të përgjithshëm të fëmijës. Të dhënat nxjerrin në pah një situatë, në të cilën elementi që del më fuqishëm është ai i ndryshimit: shkolla po ndryshon, në funksionin dhe në strukturën e saj dhe kjo ndikon në idenë që edukatoret kanë për qëllimet e punës dhe profesionalizmit të tyre. Modelet psiko–pedagogjike tradicionale, duket se nuk i përgjigjen më kërkesave të edukatoreve dhe në të njëjtën kohë kërkesat e shoqërisë bëhen më shumë të ngutshme dhe të rëndësishme. Reforma e institucionit parashkollor, treguesit e paraqitur në plan programin e ri, vendosin objektiva afatshkurtra dhe afatmesme, shumë të largëta nga situata, në cilën sot ndodhet sektori parashkollor. Devijimi që ekziston ndërmjet gjendjes reale të institucionit parashkollor, e karakterizuar nga mungesa e objekteve dhe papërshtatshmëria e tyre në lidhje me nevojat e fëmijëve (p.sh. madhësia e klasave, materiali në dispozicion,...) dhe nga elemente të tjera strukturore (raporti edukator/fëmijë, orari i punës, paga,...), përgjigjja minimale ndaj nevojës sociale (vetëm 3% e popullsisë ekzistuese frekuenton institucionin parashkollor), përgatitja e vetë edukatoreve – dhe objektivat e ndjekura nga rregulloret mund të jetë shkak i rënies së madhe të interesit dhe motivimit në punë, që karakterizon mbi të gjitha edukatoret që kanë një përvojë më të gjatë.

Në lidhje me profesionalizmin e tyre, një element që paraqitet i rëndësishëm është ai i një përkufizimi të mangët i përfaqësimit të karakteristikave edukative, që luhatet nga një programim i aktiviteteve mjaft të strukturuara në një përgjigje ndryshe dhe të individualizuar. Kjo, së bashku me faktin se nuk duket se ka referime të qarta të modeleve pedagogjike të përbashkët si referim, nxjerr në pah nevojën për trajnime të përgjithshme, për t'i përditësuar njohuritë dhe kompetencat e edukatoreve, duke filluar nga qartësimi i vlerave dhe ideve që janë në këtë punë. Në lidhje me modelin edukativ, një

element i rëndësishëm për të punuar është mbështetja e aspektit të krijimit të marrëdhënieve në këtë profesion. Mbi të gjitha, për edukatoret që punojnë me fëmijët e moshës më të vogël se 3 vjeç, individualizimi i hapave bëhet një kusht i pashmangshëm për qasjen edukative.

Sa u përket kompetencave profesionale, paraqitet nevoja e trajnimit: fakti që trajnimi, kualifikimi fillestar nuk ka qenë një kualifikim veçanërisht në planin profesional i shtohet idesë se puna e edukatores është një punë, e cila mësohet përmes përvojës personale profesionale: shkolla bëhet vendi i privilegjuar i trajnimit. Është padyshim pozitive rëndësia e trajnimit "në vend të punës" veçanërisht për ndikimin e menjëhershëm në praktikën profesionale, por mban rrezikun për të sjellë forma të ngurta dhe të mbyllura në krahasim me jashtë. Trajnimi dhe gatishmëria ndaj ndryshimit rezultojnë veçanërisht të rëndësishëm për t'iu përgjigjur objektivave, që kanë të bëjnë me riorganizimin ambicioz të sistemit shkollor, por dhe ndaj sfidave të dala nga plani për ta shtuar ndikimin në shërbimet e institucionit parashkollor dhe për përfshirjen e fëmijëve me prejardhje të ndryshme etnike dhe të fëmijëve me nevoja të veçanta.

PRINDËRIT E FËMIJËVE QË FREKUENTOJNË KOPSHTIN KARAKTERISTIKAT DHE KËNAQSHMËRITË LIDHUR ME INSTITUCIONIN PARASHKOLLOR

Përshkrimi i mostrës

Janë mbledhur 749 pyetësorë (mosha mesatare 34.42 vjeçare, ds 5.86), 157 plotësuar nga babai (21%; mosha mesatare 37,26 vjeçare), 324 nga nëna (43.3%; mosha mesatare 33.26 vjeçare), 262 prej të dy prindërve (35%; mosha mesatare 34.19 vjeçare) dhe 5 nga subjekte të tjera (0,7%; mosha mesatare 31.80 vjeçare - vetëm në dy raste është specifikuar se ishte plotësuar nga xhaxhai a tezja). Në një pyetësor nuk është treguar kush e ka plotësuar atë.

Të dhënat personale të personit që ka plotësuar formularin

Sa i përket kualifikimit, thuajse dy të tretat e të anketuarve kanë diplomë (N=482, 65%); thuajse një çerek diplomën e shkollës së mesme (N=181, 24.4%); 70 diplomën e shkollës së lartë (9.4%) dhe vetëm 9 diplomën e fillores (1.2%). Nuk ka ndryshime të mëdha në këtë variabël, nëse për ta plotësuar formularin ka qenë babai, nëna ose të dy prindërit.

Për sa i takon profesionit ndërmjet atyre që e kanë plotësuar formularin, 259 janë punonjës (35.2%), 107 (14.5%) edukatore, 55 (7.5%) punëtorë, 52 (7.1%) drejtues, 39 (5.3%) të papunë, 37 (5%) me punë të pavarur, 26 (3.5%) sipërmarrës, 24 (3.3%) të vetëpunësuar, 18 (2.4%) shtëpiake, 16 (2.2%) punonjës teknikë, 15 (2%) studente dhe 8 (1.1%) ushtarakë. Së fundi, 10.9% e mostrës ka treguar profesione të tjera, ku në shumicën e rasteve i takojnë kategorisë me punë të pavarur.

Në përgjithësi, më shumë se tri të katërtat e familjeve të fëmijëve, që frekuentojnë shërbimet parashkollore i takojnë klasës së mesme të lartë.

Profesion me kohë të plotë ishte për më shumë se tri e katërta e atyre, që e kanë plotësuar formularin (546; 77.6%); pjesa tjetër deklaron se kryen një profesion me një orar me turne (N=76; 10.8%), me kohë të pjesshme (N=46; 6.5%) ose me një orar fleksibil (N=29; 4.1%). Vetëm 7 subjekte (1%) deklarojnë të kenë orare të tjera.

Të dhënat personale të prindit që nuk e ka plotësuar formularin

Mosha mesatare e prindit tjetër, atij që nuk e plotëson formularin është 35.05 vjeçare (ds 5.65).

Për sa i takon kualifikimit, më shumë se gjysma kanë diplomë (N=401, 53.5%), rreth një e treta shkollën e mesme (N=234, 31.2%), 88 diplomën e shkollës së lartë (11.7%) edhe vetëm 13 filloren (1.7%).

Për sa i takon profesionit të prindit tjetër, 233 janë punonjës (31.1%), 69 (9.2%) mësues, 67 (8.9%) punëtorë, 55 (7.3%) drejtues, 54 (7.2%) me punë të pavarur, 53 (7.1%) të vetëpunësuar, 41 (5.5%) sipërmarrës, 26 (3.5%) të papunë, 19 (2.5%) shtëpiake, 14 (1.9%) punonjës teknikë, 13 (1.7%) studente dhe 11 (1.5%) ushtarakë. Së fundi, 9.7% e mostrës ka treguar profesione të tjera të prindit tjetër.

Profesion me kohë të plotë 594 subjekte (79.3%); pjesa tjetër deklaron se bën një punë me kohë të

pjesshme (N=35, 4.7%), me orar fleksibil; (N=31; 4.1%) ose me turne (N=28; 3.7%). Vetëm 7 (0.9%) e subjekteve deklarojnë orare të tjera.

Këto të dhëna janë koherente me ato të prindit, i cili është përgjigjur në pyetësor, duke treguar një prapavijë socio-kulturore homogjene brenda bërthamës familjare, e cila i takon klasës së mesme.

Përbërja e bërthamës familjare

Në total, janë 1426 fëmijë të të gjithë mostrës (grupmosha 0 deri 25 vjeçare), dhe mesatarisht çdo familje deklaron t'i ketë 2 fëmijë (mesatarisht 1.90 për çdo të anketuar).

Janë 960 fëmijë, që shkojnë në institucionet parashkollore dhe mosha e tyre është nga 1 deri në 6 vjeç (Tab 1). Një prind deklaron praninë e një fëmije 8 vjeç, por nuk dihet nëse bëhet fjalë për një gabim ose për një situatë specifike (aftësi e kufizuar, adoptim ndërkombëtar...) që kërkon qëndrim të zgjatur të fëmijës në institucionin parashkollor.

Pjesa më e madhe e fëmijëve, që frekuentojnë institucionin parashkollor janë ata të grup-moshës 4/5 vjeçare (48%), dhe vetëm 8,4% është nën 2 vjeçare.

Tab. 1. Mosha dhe numri i fëmijëve, që frekuentojnë institucionet parashkollore

Mosha	Nr.	Përqindja
1	81	8,4%
2	171	17,8%
3	196	20,4%
4	238	24,8%
5	223	23,2%
6	51	5,3%
8	1	0,1%
Totali	961	100,0%

Motivet e zgjedhjes së frekuentimit të institucionit parashkollor

Në figurën 1 janë paraqitur motivet, që i kanë shtyrë prindërit për të regjistruar fëmijën e tyre në institucionet për fëmijë. Nga përgjigjet, del se prindërit janë të ndërgjegjshëm, që institucionet për fëmijët janë kontekste, të cilat favorizojnë socializimin dhe zhvillimin e fëmijës, të cilat japin një garanci sigurie (edhe për sa i takon higjienës dhe pastërtisë) dhe u lejon prindërve të organizojnë më mirë jetën e tyre të përditshme dhe profesionale.

Midis motivimeve dalin aspekte të lidhura kryesisht me socializimin dhe zhvillimin edukativ, por nuk flitet kurrë për projekt edukativ. Do të ishte e duhur të kishim këtë të dhënë të ndarë sipas grup-moshave të fëmijëve.

Fig. 1 Përqindjet e përgjigjes ndaj pyetjes "Për ç'arsye keni zgjedhu ta regjistroni fëmijën tuaj në institucion parashkollor?"



Frekuentimi i institucionit parashkollor dhe zhvillimi i fëmijës (paraqitja e funksioneve të institucionit parashkollor në zhvillimin e fëmijës)

Për të hulumtuar se çfarë mendojnë prindërit për karakteristikat e fëmijëve të tyre lidhur me fëmijët, që nuk frekuentojnë institucionet parashkollore, subjektet u pyetën të shënojnë shkallën e të pajtimit/mospajtimit[22] me disa pohime.

Analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) tregoi praninë e 4 faktorëve (Tab. 2): "Dimensioni kognitiv dhe social", përfshin pyetjet, që i paraqesin institucionet parashkollore si kontekste, të cilat favorizojnë zhvillimin social dhe kognitiv "Socializimi me të rritur të tjerë", që sugjeron se si institucionet parashkollore janë vende, në të cilat është e mundur socializimi me të rritur të tjerë, nga ata familjarë. Ato, që i kemi quajtur "Justifikimet e prindërve", që tregon për justifikimet e prindërve në zgjedhjen e tyre për ta dërguar fëmijët në institucionet parashkollore dhe e fundit, që ka dalë edhe te edukatoret "Privimi", që përbëhet nga çështje që e përshkruajnë shërbimin si një kontekst privues.

"Dimensioni kognitiv social" dhe "Socializimi me të rriturit" janë dimensione që tregojnë një shkallë pajtimi mjaft të lartë, për të treguar ndërgjegjësimin nga ana e prindërve se shërbimet parashkollore janë kontekste pozitive për fëmijët, të cilët i frekuentojnë ato. Në veçanti, tema e respektimit të rregullave del në pah edhe në grupet e fokusit, dhe paraqet një ndjeshmëri të veçantë ndaj këtij argumenti, shumë të rëndësishëm në vitet e para të jetës. Dy dimensionet e tjera paraqesin një shkallë pajtimi më të ulët dhe kjo e dhënë sugjeron se sipas prindërve, fëmijët që frekuentojnë shërbimet nuk janë të pafavorizuar në krahasim me bashkëmoshatarët, të cilët i frekuentojnë shërbimet parashkollore.

22 1=aspak dakord, 2=pak dakord,3=mjaft dakord,4=shumë dakord

Tab. 2 Karakteristikat e fëmijëve që i frekuentojnë institucionet parashkollore në raport me ata që nuk i frekuentojnë ato. Mesatarja dhe devijimi standard.

Fëmijët që i frekuentojnë institucionet parashkollore në raport me ata që nuk i frekuentojnë ato	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
DIMENSIONI KOGNITIV DHE SOCIAL	**728**	**3.45**	**.55**
Mësojnë para të tjerëve për t'i respektuar rregullat	738	3.40	.779
Kanë më shumë raste për të ndërtuar raporte domethënëse me bashkëmoshatarët	743	3.59	.659
Stimulohen më shumë në aspektin intelektual	739	3.36	.764
SOCIALIZIMI ME TË RRITURIT E TJERË	**724**	**3.01**	**.71**
Bëhen më herët të pavarur	729	3.26	.824
Ndërtojnë raporte afektive me të rritur të tjerë	734	2.78	.892
JUSTIFIKIMET E PRINDËRVE	**701**	**2.64**	**.66**
Kanë në dispozicion hapësira të brendshme dhe të jashtme më të përshtatshme për kërkesat e tyre	732	2.97	.857
Kanë prindër më në dispozicion në orët që kalojnë me ta	719	2.66	.939
Kalojnë shumë pak kohë me prindërit	720	2.29	.907
PRIVIMI	**710**	**2.10**	**.63**
Nuk kanë mundur t'i kalojnë në shtëpi vitet më të rëndësishme të zhvillimit të personalitetit	733	2.93	1.005
Bëhen më prepotentë dhe agresivë	730	1.95	.948
Janë të detyruar ta përshtatin personalitetin e tyre jetës në grup	724	1.88	.933
Kalojnë pjesën më të madhe të kohës në një ambient artificial dhe pak stimulues	737	1.66	.861

Me pyetjen tjetër, prindërit u pyetën nëse falë frekuentimit të institucioneve parashkollore, fëmija i tyre ka pasur disa avantazhe Tab 3)[23]. Analiza e komponentëve kryesorë (rotacioni varimax) ka paraqitur praninë e dy dimensioneve: "Të mësuarit social", ose të mësuarit që ndodh në procesin e socializmit, dhe "Të mësuarit formal" ose ato kompetenca që lidhen me sferën fizike, afektive dhe të ndryshimit.

Të dy dimensionet paraqesin pikë mesatare mjaft të larta, që tregojnë se prindërit janë të vetëdijshëm, që fëmijët të cilët i frekuentojnë institucionet parashkollore kanë përparësi në proceset e të mësuarit.

23 Shkalla me 4 pikë (1=aspak, 2=pak,3=mjaft,4=shumë)

Tab. 3 Avantazhet e fëmijës që e frekuenton institucionin parashkollor sipas prindërve. Mesatarja dhe devijimi

Avantazhet e fëmijës që e frekuenton institucionin parashkollor sipas prindërve	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
Të mësuarit social	728	3.51	.53
Socializimi dhe bashkëpunimi me fëmijët	729	3.65	.59
Të mësuarit e rregullave dhe sjelljen	711	3.53	.71
Gjuha	721	3.38	.78
Socializimi dhe bashkëpunimi me të rriturit	715	3.29	.74
Të mësuarit formal	726	3.26	.74
Autonomia fizike	701	3.19	.77
Autonomia afektive	691	3.17	.78
Tërheqja dhe ndryshimi	688	3.10	.94

Hapësirat dhe organizimi i institucionit parashkollor

Kërkesës për ta vlerësuar cilësinë e hapësirave të brendshme të institucionit parashkollor, prindërit i përgjigjen thuajse në unanimitet mjaft pozitivisht (Fig. 2).

Fig. 2 Përqindjet e përgjigjes ndaj pyetjes "Hapësirat e brendshme të institucionit parashkollor, sipas mendimit tuaj janë:"



Edhe hapësirat e jashtme janë vlerësuar pozitivisht nga pjesa më e madhe e prindërve (Fig. 3), përveç zërit "Të përdorura mjaftueshëm" ku përqindja e përgjigjeve "Po" nuk mbërrin për pak 50%.

Fig. 3 Përqindjet e përgjigjes ndaj pyetjes "Hapësirat e jashtme të institucionit parashkollor, sipas mendimit tuaj janë:"



Në lidhje me kërkesën për të treguar nëse familjet konsiderojnë të nevojshme një shtim të orarit të hapjes së institucionit parashkollor (Fig. 4), pak më shumë se 40% e subjekteve deklarojnë se do të ishte mirë, nëse institucioni do të ishte i hapur edhe gjatë periudhës së verës dhe më shumë se 30% "të gjitha ditët krahas orarit aktual të mbylljes së institucionit parashkollor". Përbëjnë më pak se 20% të mostrës, ata që kërkojnë që të jetë e hapur edhe të shtunën dhe gjatë festave fetare dhe më pak se 10% ata që do të donin, që institucioni parashkollor të ishte hapur edhe të dielën.

Fig. 4 Përqindjet e përgjigjes ndaj pyetjes "Për nevojat tuaja e konsideroni të duhur që institucioni parashkollor të qëndrojë i hapur për një kohë më të gjatë"



Raporti ndërmjet familjes dhe institucionit parashkollor

Pjesa e mëposhtme i pyetësorit paraqet hulumtimin e raporteve ndërmjet familjes dhe institucionit parashkollor. Pyetjes, për t'i vlerësuar mënyrat e mbajtjes së kontakteve ndërmjet familjarëve dhe edukatoreve (Fig. 5), më shumë së gjysma e mostrës jep vlerësime pozitive; vetëm në lidhje me shpeshtësinë e takimeve shohim se thuajse një e pesta e prindërve deklarojnë se takimet mund të jenë më të shpeshta. Megjithatë, rreth 80% deklarojnë se këto takime janë "të shpeshta" ose "mjaft të shpeshta".

Pra, ka një dëshirë për t'i takuar edukatoret dhe të qenit "aktiv" në institucionin parashkollor, duke marrë pjesë aktivisht në iniciativat shkollore, që përfshijnë fëmijët e tyre.

Fig. 5 Përqindjet e përgjigjes ndaj pyetjes "Sipas mendimit tuaj, mënyrat e mbajtjes së kontaktit ndërmjet familjarëve dhe edukatoreve (takime, mbledhje etj.) janë:"



Edhe në lidhje me mënyrat se si Institucioni parashkollor i pret fëmijët, prindërit në përgjithësi shprehen pozitivisht (Fig. 6): përgjigjet "jo" ose "nuk e di" afrohen gati te 10%, në të gjitha mundësitë e mundshme për përgjigje.

Fig. 6 Përqindjet e përgjigjes ndaj pyetjes: "Sipas mendimit tuaj, mënyrat me të cilat institucioni parashkollor i pret fëmijët janë:"



Kënaqshmëria në lidhje me personelin e institucionit parashkollor

Pjesa përfundimtare e pyetësorit ishte përqendruar në vlerësimin e personelit shkollor (Tab. 4) dhe ndihmës (Tab. 5)[24]. Në përgjithësi, prindërit e vlerësojnë si personelin e institucionit parashkollor dhe personelin ndihmës, pozitivisht, në të gjitha dimensionet e propozuara. Në veçanti, ai shkollor konsiderohet kompetent me fëmijët dhe në dispozicion në lidhje me sigurinë dhe shëndetin e të vegjëlve. Ndërsa, ai ndihmës ka aftësi të shkëlqyera në krijimin e marrëdhënieve me fëmijët dhe kompetent për punën specifike që kjo figurë kryen.

Tab. 4 Vlerësimi i personelit parashkollor: Mesatarja dhe devijimi

Personeli i institucionit parashkollor është:	Nr.	Mesatarja	Dev. Stand.
Kompetent në lidhje me planifikimin mësimor	703	3.43	.75
Kompetent në lidhje me përmbajtjen e mësimit	680	3.43	.74
Kompetent në lidhjen me fëmijët	731	3.40	.79
I kujdesshëm për sigurimin dhe shëndetin e fëmijës	725	3.38	.84
Në dispozicion	723	3.37	.82
Kompetent në lidhje me të rriturit	716	3.33	.78

Tab. 5 Vlerësimi i personelit ndihmës: Mesatarja dhe devijimi

Personeli ndihmës është:	**Nr.**	**Mesatarja**	**Dev. Stand.**
I aftë për të krijuar marrëdhënie me fëmijët	672	3.35	.76
I përfshirë në jetën shkollore	619	3.33	.75
I aftë për të krijuar marrëdhënie me të rriturit	669	3.30	.77
Kompetent për punën e tij	670	3.29	.75

Koment mbi të dhënat

Nga analiza e të dhënave paraqitet një kënaqshmëri e përgjithshme dhe pozitive ndaj shërbimeve edukative, të paraqitura në të gjitha aspektet e tyre (ambient, strukturë, personel, edukatorë dhe ndihmës).

Grup-mosha e përfaqësuar më shumë është ajo 4/5 vjeçare (pra, përfshihet një pjesë e mirë e fëmijëve në periudhën parashkollore). Ndërsa, ende i dobët është frekuentimi i këtyre institucioneve nga fëmijët e moshës nën 2 vjeçare. Duhet punuar me këtë grup-moshë, duke i sensibilizuar familjet, duke shuar ndonjë dyshim, që ndoshta ende ekziston ("në këtë moshë janë shumë të vegjël për të shkuar në çerdhe, sepse nuk u duhet....ky është një tregues që del nga grupi i fokusit"). Përvoja shkollore, në fakt, duke filluar nga më të vegjëlit, është themelore për përftimin e kompetencave dhe të mësuarin funksional për zhvillimin e plotë të fëmijës.

Një e dhënë tjetër relevante që del është frekuentimi më i madh i institucioneve parashkollore nga fëmijët, që i përkasin shtresës së mesme të lartë të shoqërisë. Duhet theksuar që të frekuentohen institucionet parashkollore nga fëmijët, që vijnë nga situata familjare të pafavorshme dhe jo vetëm për klasat e mesme të larta, duke i dhënë një shtysë mirëqenies dhe zgjidhjeve të diferencuara (tarifa minimale, pagesa), që i mundësojnë kësaj shtrese të drejtën e plotë për të marrë pjesë në jetën shkollore.

Së fundi, një mënyrë do të ishte ajo e theksimit të karrierës universitare, që formon figura profesionale edukative (dhe jo mjekësore) specifike për grup-moshën 0-3 vjeçare. E gjitha kjo do të rezultonte e duhur për t'i shuar paragjykimet rreth kësaj grup-moshe dhe mbi të gjitha idenë se këta fëmijë kanë vetëm nevoja elementare, ndërsa çdo moshë duhet ta ketë të drejtën të regjistrohet dhe të ketë një zhvillim edukativ të plotë.

24 Shkalla me 4 pikë (1=aspak, 2=pak,3=mjaft,4=shumë)

PËRFSHIRJA E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA DHE FËMIJËVE NGA KOMUNITETET RAE - FJALËT E PRINDËRVE TË TYRE

Nga dhjetori 2013 deri në janar 2014 janë mbledhur 7 fokus-grupe, 4 fokus-grupe nga komunitetet RAE, 2 fokus grupe me fëmijë me nevoja të veçanta, dhe 1 fokus grup nënë gjidhënëse. Qëllimi ishte për t'i kuptuar motivimet, që i shtyjnë familjet e komuniteteve RAE për t'i dërguar (mos dërguar) fëmijët e tyre në institucionet edukative (çerdhe, institucion parashkollor, shkollë fillore) dhe për të kuptuar se cilat mund të jenë pengesat dhe vështirësitë me të cilat ndeshen. Gjithashtu, objektiv tjetër i fokusit ishte ajo për të treguar rutinën e përditshme në lidhje me kujdesin ndaj fëmijëve (ushqyerje, gjumë, etj.).

Në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuar, qëllimi i fokusit ishte të kuptonim procesin e përfshirjes sociale në institucione dhe problematikat specifike të lidhura me këtë synim.

Ndaj, rruga e ndjekur e fokus-grupit është si më poshtë:

TË DHËNAT SOCIO-PERSONALE

1. Sa fëmijë, vjeç (mosha, gjinitë…)
2. Mosha e pjesëmarrësve dhe në cilën moshë e kanë pasur fëmijën e parë
3. Ku jetojnë (shtëpi....) dhe cila komunë (zonë rurale, qytet..)
4. Gjendja e punësimit të nënës/babait (nëse punojnë, ku, të papunë..)
5. Niveli i shkollimit të nënës/babait

2. RRUGA

Identifikimi i temave qendrore dhe kërkimi për t'i afruar njerëzit me temën pa digresione. Personat duhet të flasin me njëri-tjetrin dhe jo me intervistuesin, dhe të diskutojnë ndërmjet vete!

1. FREKUENTIMI I SHËRBIMEVE PËR FËMIJË- fëmijët e moshës 0/3 qëndrojnë në shtëpi? Shkojnë në çerdhe? Nëse jo, përse dhe cilat janë motivet kulturore... (tregoni arsyet dhe mentalitetet që fshihen pas kësaj)

Nëse do të kishte shërbime për fëmijët në qytetin tënd, a do t'i përdorje? Për çfarë mund të duhen (prioritetet? Për nënat dhe fëmijët? Vetëm për fëmijët? Hulumtimi i arsyeve)

Cilat janë kërkesat e tua?

A mendon se një edukator/edukatore mund të jetë i nevojshëm/shme? Në cilën mënyrë? Hulumtimi i arsyeve.

1. USHTRIMI, KUJDESI, NEVOJAT – Cilat janë zakonet tuaja në lidhje me kujdesin 0/3.. (çfarë bëni?)
2. Në lidhje me lindjen (procedurat, regjistrimi..)

3. Për ushqimin dhe ushqyerjen me gji
4. Për gjumin
5. Për lojërat, bashkëveprimi me pjesën tjetër të familjes (gjyshër, vëllezër…)
6. Zhvillimi i gjuhës (gjuha mëmë?)
7. Në rastin e sëmundjeve foshnjore
8. Për shëndetin e fëmijës
    a. Çfarë duhet, në komunitetin tuaj, në lidhje me edukimin dhe kujdesin e fëmijëve 0/3 vjeçare?
    b. Së fundi, çfarë duan (për çfarë kanë nevojë) fëmijët?

ANALIZA E FOKUSIT

Fokusi për atë që rezulton nga transkriptet, është nga intervistat në grup. Pak herë ka pasur një diskutim të gjatë midis subjekteve të përfshira dhe kryesisht përgjigjet i janë dhënë veçmas intervistuesit. Rrjedhimisht, mungon disuktimi i gjatë dhe më i thelluar ndërmjet pjesmarrësve, ndoshta kjo i atribuohet faktit që pjesmarrësit nuk kanë pasur përvojë me këtë lloj metodologjie.

a) Mostra

7 fokus-grupe kishin 7-10 persona secili. Gjithsej kanë marrë pjesë 54 subjekte, 53 gra dhe vetëm 1 burrë.

Mosha mesatare e mostrës nuk është e pranishme sepse e dhëna nuk është e vazhdueshme (10 përgjigje në 54, shumica e pjesëmarrësve ishin nga komunitetet RAE). Pjesa më e madhe nuk kanë një punë (vetëm 4 kanë deklaruar të kenë punë). Janë të gjitha gra me fëmijë, mesatarja është 3,2 fëmijë secili (në mostër kanë të pranishëm 4 gjyshe dhe të afërm dhe 3 persona që nuk kanë fëmijë). Niveli i shkollimit është i ndryshëm: nga ata pa shkollë (9, të gjithë pjesëmarrësit ishin nga komunitetet RAE), me fillore (12), me të mesme (1), me të lartë (11) dhe me diplomë (6).

Në mënyrë specifike, mostra e 2 grupeve të fokusit me prindër të fëmijëve më aftësi të kufizuara paraqet një nivel shkollimi më të lartë: me fillore (2), me të lartë (3), me diplomë (4) ndërsa për 7 pjesëmarrës nuk ka të dhëna.

b) *Procedura*

Fokus-grupet janë organizuar në qytete të ndryshme: 3 në Prishtinë (rreth 200.000 banorë, pjesa më e madhe shqiptarë), 2 në Prizren (165.000 banorë, pjesa më e madhe shqiptarë), 1 në Pejë (81.800 banorë), 1 në Mitrovicë (84.234 banorë, studimi vetëm në pjesën jugore, sepse qyteti ka gjithashtu dy administrata, një serbe në pjesën e veriut dhe një kosovare në pjesën e jugut).

Pjesëmarrësit janë qasur në spitale, në institucionet edukative dhe në hapësira arsimore.

Analiza e të dhënave

Analiza e përmbajtjes së fokusit nxjerr në pah realitete shumë të ndryshme, pavarësisht nga numri i banorëve të qyteteve të marra në konsideratë. Në Prishtinë, ekzistojnë mundësi më të mëdha në krahasim me qytetet e tjera, që paraqiten shumë në vështirësi për këto institucione (shkolla fillore dhe spitale). Ndërsa, në fshatra nuk ka asgjë.

"Është e vështirë për ne nga fshati të udhëtojmë.

Ju në fshat nuk keni një institucion parashkollor?

Jo".

(Fokus 7 -P6)

Frekuentimi i institucioneve edukative.

Treguesi i parë interesant pas analizimi të grupi të fokusit është ndryshimi midis qytetit dhe fshatit. Në fshat nuk ka thuajse asnjë mundësi për ta dërguar fëmijën në çerdhe ose kopsht pasi nuk ekzistojnë.

"Në fshat nuk ka institucion për edukimin e fëmijëve" (Fokus 5 - F5)

Një ndihmë e rëndësishme mund të vinte nga organizatat ndërkombëtare, që disa herë kanë hapur struktura për fëmijët ku tarifa është e ulët (5 euro në muaj, dhe madje falas për fëmijët e të rënëve ose atyre që i kanë prindërit e zhdukur) dhe me cilësi të shkëlqyer.

Një element tjetër i nevojshëm për të reflektuar ka të bëjë me konfuzionin midis çerdhes, kopshtit dhe parashkollorit. Ndjesia është sipas edhe asaj që shumë pjesëmarrës thonin për kopshtin, por në realitet i referoheshin parashkollorit i cili pranon fëmijët prej moshës 5 vjeçare. Në përgjithësi, frekuentimi i çerdhes dhe kopshtit është shumë i ulët, dhe kjo ka të bëjë me shërbimin e dobët, po dhe me koston (shpesh shërbimet janë private dhe tarifat janë të larta 90 – 170 euro në muaj) si dhe shkak i një mosinformimi të përgjithshëm.

Të hysh në strukturat publike është e vështirë, sepse sipas asaj që pohojnë të intervistuarit "*nëse nuk njeh ndonjë nuk mund të bësh asgjë. Duhet të kesh ose të njohur ose para për ta regjistruar fëmijën" (fokus 5 - F6)*

Një zgjidhje e mundshme do të ishte një fushatë me e madhe dhe më e qartë informuese (në vende dhe ambiente të ndryshme) që ta ndihmojë popullsinë të çlirohet nga ato dyshime, që krijohen pikërisht për shkak të mosinformimit.

Motivimet, që i shtyjnë prindërit për t'i dërguar fëmijët në parashkollor ose në kopsht (por jo shumë) janë për socializimin e fëmijëve, për të mësuar gjëra të reja, për të mos qëndruar me të rriturit dhe për t'i hequr pak "*nga rruga". Këtu të paktën janë të sigurt, nuk dalin në rrugë, nuk është rreziku i makinave, dhe nuk i keqtrajton askush. Këtu është shumë mirë dhe kur i sjellim fëmijët këtu edhe ne ndjehemi mirë" (*i referohen institucionit parashkollor për nxënësit 3-6 vjeç *fokusi 6 - F5)*.

Gjithashtu, "*për një edukim më të mirë, që të mësojnë të sillen mirë si me prindërit dhe me shokët dhe me gjithë të tjerët normalisht" (fokus 4 – F1)*

"Bën detyra, mëson poezi, di gjithçka, germat i di të gjitha, është shumë mirë" (fokus 4 -F2)

"Normalisht ata me parashkollorë i dinë të gjitha, janë më të gatshëm, mësojnë dhe të sillen më mirë me edukatoret, dinë si të rrinë" (fokus 4 – F1).

Nëse do të ishte e mundur, të gjithë janë të pajtimit për të dërguar fëmijët në kopsht, sepse

"*...nuk duhet të qëndrojë vetëm me nënën" (fokus 1 – F2)*

"për t'u socializuar"

"do të ishte më mirë, sepse fëmijët fillojnë që të vegjël për të qenë më të socializuar, më komunikues me të tjerët" (fokus 1 – F2)

Dhe, mundësitë mund të jepen vetëm duke nxitur dhe duke promovuar politika të mirëqenies ose të paktën një pagë minimale për të gjithë.

"*Gjendja ekonomike, papunësia...nëse marrim diçka, një pagë modeste, sigurisht mund ta ofronte mundësinë..*" (fokus 5 – F4).

"..mungojnë kushtet ekonomike.." (fokus 7 – P6- P3)

"..nuk kemi menduar po nuk i kemi mundësitë" (fokus 7 – P3)

Dikush nuk ka as veshje për fëmijët "*Unë kam 3 fëmijë që shkojnë në institucionet parashkollore, më besoni shpesh nuk kanë këpucë ose rroba për të veshur (Fokus 6 – F2).*

"Paratë të hapin dyert" (fokus 6 – F3),, kur nuk ke para nuk i pranojnë as në institucione parashkollore (Fokus 6- F5).

"Problemi është vetëm kjo varfëri! (Fokus 6, F5).

Një element interesant, që gjendet shpesh në literaturën psiko-sociale mbi migracionin dhe funksionin e fëmijëve si instrumente përmirësimi dhe progresi dhe për prindërit. Fëmijët bëhen shumë shpesh ndërmjetës ndërmjet familjes dhe institucioneve, ndryshojnë vlerat dhe pikat e referimit, sikurse na thotë një nënë:

"...kur ai kthehej në shtëpi fliste si i rritur, jo si fëmijët […] Kur shkonte në kopsht përshtatej lehtë, pastaj ishte pak më ndryshe, mësonte gjëra, ngjyrat, dhe pastaj na korrigjonte kur flisnim në shtëpi, na thoshte "nuk thuhet ashtu, por kështu" dhe më pas i ka harruar fjalët që thoshte më parë në shtëpi dhe i referohej fjalëve që i thoshte edukatorja" (fokus 5 - F1)

Nga ana tjetër, dihet së fëmijët që jetojnë në kushte optimale me prindër, të një cilësie të lartë, me qasje në edukimin e fëmijërisë së hershme, dhe me ekonomi të qëndrueshme, kanë më shumë gjasa për të pasur prosperitet se fëmijët pa këto mundësi, që vuajnë në shumë mënyra nga një cikël i vazhdueshëm stresi, mosangazhimi, dhe gjendje shëndetësore të keqe. (Abrams & Killen, 2014).

Kushtet në institucionin parashkollor

Për fat të keq, kjo pikë nuk është hulumtuar shumë në të gjitha fokus-grupet. Të dhënat që kemi përshkruajnë situata disa herë pozitive dhe disa herë të vështira. Ato pozitive i referohen pastërtisë në klasa dhe edukatoreve të mira, ndërsa kushtet janë të rënda jo në lidhje me edukatoret, që konsiderohen të zonja dhe shumë të zonja, por në organizimin e institucionit parashkollor:

"...kur e kam dërguar fëmijën tim në institucion parashkollor ajo (edukatorja) kishte edhe 40 fëmijë në klasë, dhe mendova se kjo nuk do të ishte diçka e mirë, nuk më pëlqenin karriget, fëmija më thoshte se i dhembte shpina, për dy javë në një karrige uleshin dy fëmijë .." (fokus 5, F1).

Rrjetet ndihmëse

Kryesisht rrjetet ndihmëse janë familja dhe vjehrra.

Paragjykimet

Janë ende të ndryshme "paragjykimet" në lidhje me çerdhen sepse " (fëmija) *duhet të ketë të paktën dy vjeç, pasi nuk ka asnjë efekt te fëmija 1 vjeç " (fokus 5- F6).*

Fëmijët me aftësi të kufizuar

Veçanërisht, janë dy fokus-grupe të zhvilluara me prindërit e fëmijëve më aftësi të kufizuara (trizomia 21, *paraliza cerebrale,* autizmi, problemet kardiake, paaftësia fizike) dhe këto situata kanë vështirësi ekstreme. Nënat deklarojnë se nuk kanë pasur ndihmë nga shërbimet dhe nuk i dërgojnë fëmijët në institucione parashkollore sepse

"...duhet të paguajmë një person për të..." (fokus 2 - F1)

"..mungojnë kushtet ekonomike" (fokus 7 - P6)

Unë kam provuar ta dërgoj në kopsht fëmijën tim kur kishte 5 vjeç (fëmija është i prekur nga paraliza cerebrale, sipas nënës). *Kam qenë në kopsht dhe kam qenë e gatshme të paguaja dhe asistenten.* Më kanë lënë të prisja dy vjet "një herë këtë muaj e pastaj muajin tjetër" deri sa fëmija ime mbushi 7 vjeç[…]

dhe në fund u desh ta dërgoja në institucionin parashkollor special". (fokus 2 -F3)

"Këta (Ministria) i kanë bërë ligjet për interesat e tyre, si kanë dëshirë ata, nuk paguajnë një asistente dhe vetëm nëse i paguan vetë mund ta dërgosh fëmijën" (fokus 2 – F3)

Në këtë rast, problemi është i dyfishtë, sepse nuk ka mundësi dhe ato të pakta kërkojnë dhe të tjera. Pjesa më e madhe e personave të intervistuar nuk punojnë, gratë thuajse asnjëra, burrat herë pas here, dikush jeton me asistencën e shtetit, madje edhe dikush, sidomos në Pejë, me ndihmën e fqinjve.

"*dhe nëse gjen dikë që të merret me fëmijët është një problem, atëherë të rrimë në shtëpi, përse të paguash dikë? Shumë pak punojnë nënat" (Fokus 7 - P3)*

Kjo është me të vërtetë një dramë, është e nevojshme që Qeveria e Kosovës të investojë në punë ose të garantojë një asistencë për familjet me fëmijë. Vetëm kështu mund të ketë shërbime më të mira dhe me frekuentimin e duhur. Familjet që u mungon ndihma dhe mbështetja institucionale është vetëm përmes individëve privatë që përfitohet diçka.

"*...këtu tek ne shumë nuk kanë as mbështetjen e familjes […] Nuk kanë mbështetjen e familjes së tyre, të miqve dhe të afërmve dhe të mos flasim për qeverinë që, siç e di e dhe ti (*intervistueses) *nuk e di nëse e dinë që ne ekzistojmë në ndonjë vend dhe kjo është me të vërtetë një problem". (fokus 2 - F8)*

"...shteti nuk të ndihmon. Sepse asnjë prindi, asnjë familjeje nuk i pëlqen të shohë fëmijët që nuk përparojnë, të mbyllur dhe me nevoja të veçanta" (fokus 7 - P3)

"*tek një privat e bëjmë terapinë, paguajmë 200 euro në muaj vetëm për ushtrimet.." (fokus 2 – F4)*

Ndryshe, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar potencojnë se *"gjithçka e kemi bërë vetë" (fokus 2 -F4)*

"Unë nuk kam mundur ta çoj askund, unë nuk kam para, nuk kam pasur asgjë për ta çuar fëmijën tim diku, për të folur ose për të ecur normalisht dhe as tek logopedi apo diku tjetër" (fokus 2 – F4)

Por dhe në nivelin mjekësor theksojnë mangësi dhe moskompetencë: *"Si nënë më është dashur të bëj vetë një zgjidhje, kam lexuar në serbisht dhe anglisht, sepse në shqip ka shumë pak material në internet. Edhe pse kam shkuar në mjekë dhe institucione të ndryshme dhe tek mjekët privatë, asnjë mjek nuk ka mundur të më tregojë së cili është trajtim i duhur për të bërë, ndaj është dashur të shoh vetë se çfarë mund të bëhej". (fokus 2 - F8)*

Zgjidhjet

Zgjidhja vjen direkt nga të intervistuarit: "*duhet sensibilizuar opinioni publik për të mos diskriminuar të tjerët, duhet bërë gjithçka për këta fëmijë, nuk thuhet "është i sëmurë" Jo, fëmija im nuk është i sëmurë "*. (fokus 2 - F6)

"Duhet sensibilizuar opinioni publik sepse jemi shumë larg, shumë larg...nuk ka edukatë" (fokus 5 – F6).

Përkujdesja, Edukimi, Zakonet (Ushqimi)

Sa i përket përkujdesjes ndaj fëmijëve, shumica e nënave deklaruan që ato vetë përkujdesen për fëmijët e tyre. Në kohën kur ato nuk janë në shtëpi për arsye të ndryshme, personat të cilët më së shumti kuj-

desen për fëmijët janë vjehrra, kunata e në disa raste edhe burri.

"*Nëse më duhet të dalë nga shtëpia, fëmijën e lë në përkujdesje të kunatës dhe kujdeset për te për 1 ose 2 orë*" (fokus 3, F7)

Përgjatë diskutimit në fokus grup lindën edhe pyetje lidhur me kualitetin e përkujdesjes dhe format e edukimit të fëmijëve.

Në një pyetje të përshtatur *"a ju tregoni p.sh ky është gjethi, ka këtë ngjyrë, këtë formë, a bisedojnë me fëmijët në këtë formë?"*

Përgjigjja ishte si vijon: "*Gjatë tërë kohës shikojmë filma vizatimor së bashku me fëmijët"* (fokus 4, F1)

Kur janë pyetur për kualitetin e përkujdesjes ndaj fëmijës prej vjehrrës, kunatës apo bashkëshortit (babait të fëmijës) rezulton se kujdesen më shumë në aspektin e mbrojtjes fizike.

"*Nëse ka ndonjë lodër, ja ofron që të luaj me të, por nëse nuk ka e mban nën kontrroll të mos rrëzohet dhe e ushqen*" (fokus 3, F5)

Sa i përket kujdesit shëndetësor, pjesëmarrësit në fokus grupe deklarojnë se kur kanë mundësi i dërgojnë fëmijët në kontroll mjekësor.

"Barërat janë pa pagesë, përderisa kontrollimi është me pagesë"(fokus 3, F1)

Ndodh ndonjëherë që çdo javë i dërgojnë në kontrolle se fëmijët sëmuren shumë shpesh.

Sa i përket praktikave të ushqimit ato rezultojnë të jenë të rregullta, ankesat më të mëdha vijnë nga prindërit që kanë provuar t'i dërgojnë fëmijët në kopsht, mirëpo nuk janë ndarë të kënaqur, njëri nga faktorët e pakënaqësisë ishte edhe ushqimi.

"Edhe pijet, ka pasur pije të thjeshta, e të lira, që edhe ngjyrën nuk kisha mundësi t'ja hiqja nga biberoni, kam 180 Euro për të dytë për një muaj, nuk është çmim shume i ulët, qe me pi fëmija im lëngje të lira""(-fokus 1, F1)

Si përfundim nga fokus-grupet paraqiten probleme të ndryshme, por edhe zgjidhje:

1. Paraqitet një konfuzion dhe pak qartësi në dallimin e tipologjive të shërbimeve (çerdhe, kopsht dhe parashkollor). Ndjesia është se kur flitej për kopshtin, shumë e ngatërronin me parashkollorin. Zgjidhja do të ishte ajo e studimit të një fushate informuese të qartë (informacione më të shumta dhe më të mira) që të arrijnë te e gjithë popullsia, nga personat e shkolluar dhe deri te ata më pak, nga qyteti në zonat rurale. Të studiohen fushata informuese të dallueshme dhe të kuptueshme për të gjithë sipas targetit (çerdhe, kopsht...).
2. Vështirësi tjetër e rëndësishme që pengon fëmijët më të vegjël t'i frekuentojnë shërbimet e çerdhes dhe të kopshtit janë kushtet ekonomike dhe jetesa e keqe e shumë personave, për shkak të mundësive të punës, si për burrat ashtu dhe për gratë.Zgjidhja mund të jetë ajo fuqizimit të sistemit të mirëqenies ose të paktën të sigurohet një asistencë minimale për familjet pa të ardhura ose me të ardhura shumë të ulëta. Aktivizimi i politikave që u mundësojnë punësim edhe grave.
3. Për fëmijët me aftësi të kufizuar theksohet mungesa e mbështetjes psikologjike publike dhe e strukturave publike që i pranojnë këta fëmijë. Gjithashtu, ky tregues shpesh ndërlidhet me kompetencën e ulët dhe përgatitjen mjekësore.
4. Zgjidhja mund të ishte e ajo e fuqizimit të strukturave publike, duke paguar edukatore mbështetëse dhe të organizohen trajnime, të cilat i përgatisin edukatoret e institucionit parashkollor për pranimin dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

REKOMANDIME

FILLIMI NGA TË GJETURAT E HULUMTIMIT – NISMAT AVOKUESE DHE NDËRHYRJET E SYNUARA

Të promovohet një kulturë e fëmijërisë, e cila merr më shumë në konsideratë nevojat e Fëmijërisë së Hershme. As prindërit e as edukatoret nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për rolin qendror, që luan edukimi në moshën e fëmijërisë, dhe veçanërisht në tri vitet e para të jetës së fëmijëve.

Në pikëpamjen ekologjike (Bronfenbrenner, 1979) promovimi i kulturës së fëmijërisë kërkon ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme në tri nivele të ndryshme:

- Sensibilizimi i opinionit publik për Konventën e të Drejtave të Fëmijës (KDF). KDF-ja mund të jetë korniza ligjore dhe kulturore për trajtimin e zgjedhjeve politike dhe shoqërore të vendit.
- Këto qëllime mund të përfshijnë fushata sensibilizuese, të cilat synojnë si politik-bërësit kombëtarë ashtu edhe ata lokalë, si përmes veprimeve në kuadër të shkollave, ashtu edhe përmes gjetjes së mënyrave për përfshirjen e familjeve.
- Promovimi dhe mbështetja, bashkëpunimi, bashkërendimin dhe energjitë ndërmjet fushave të ndryshme publike, të përfshira në kujdesin në moshën e fëmijërisë dhe në veçanti sektorët edukativë, socialë dhe shëndetësorë.
- Kjo është veçanërisht e rëndësishme për veprimet që ndërmerren me fëmijë nga mosha e lindjes deri në atë tri vjeçare. Në Kosovë, vijimi i kopshteve është shumë i ulët (3%), ndërsa edukimi i obliguar fillon në moshën 5 vjeçare, sipas ligjit Nr. 04/L-032 dhe mund të hyjë në fuqi që nga viti 2015/2016. Në këtë kontekst, ofruesit e shërbimeve sociale dhe shëndetësore, dhe në veçanti pediatrit, janë profesionistët, të cilët mund t'i takojnë të gjitha familjet, duke filluar nga periudha e shtatzënisë së nënave e deri në lindje. Programet për mbështetjen e prindërve do të mund të projektohen në bashkëpunim midis shërbimeve shëndetësore dhe atyre edukative (d.m.th. Programet për përgatitjen për lindje ose programet për mbështetjen e ushqyerjes me gji,...); programet për mbështetjen e prindërve janë veçanërisht të rëndësishme për t'i përgatitur, informuar dhe mbështetur familjet me fëmijë me nevoja të veçanta.
- Promovimi dhe mbështetja e vijimit të kopshteve dhe shërbimet e Edukimit dhe Kujdesit në Fëmijërinë e Hershme (EKFH).

Në të vërtet, ky qëllim është shumë kompleks dhe i referohet veprimeve të ndryshme.

a. Lehtësimi në qasjen në EKFH për të gjitha familjet. Analiza e të dhënave thekson se fëmijët të cilët vijojnë EKFH-në në Kosovë, i përkasin, në pjesën më të madhe, klasës së mesme të lartë. Ekziston nevoja për ta ofruar një numër më të lartë të shërbimeve publike të EKFH-së, si dhe për t'i përmirësuar ato. Studime të ndryshme (Noally, et.al. 2007, Vanderbroeck et al, 2010) theksojnë se aty ku menaxhimi i shërbimeve të EKFH-së varet nga sektori privat (qasja e bazuar në treg), shërbimet përqendrohen në zonën urbane, duke favorizuar familjet që kanë mundësi, por nuk janë të pranishme në zonat rurale a lagjet e varfra.
b. Sigurimi i qasjes në EKFH për të gjithë fëmijët, duke inkurajuar frekuentimin nga ana e fëmijëve me nevoja të veçanta ose fëmijëve të grupeve minoritare etnike (RAE, etj.). Analiza e të dhënave të fokus-grupeve sugjeron se është e nevojshme që programi të zbatohet për t'i hequr pengesat burokratike (pengesat gjuhësore, procedurat e vështira,....), pengesat ekonomike (kostot e shërbimeve) dhe ato kulturore (pengesat kulturore dhe fetare, paragjykimet ndaj mundësisë për edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta,...)
c. Mbështetja jo vetëm në sasi e EKFH-së, por gjithashtu edhe cilësi, në mënyrë që të rriten njohuritë rreth rëndësisë së edukimit nga lindja deri në moshën tri vjeçare, si dhe besimin në rezultatet e sistemit shkollor për një shoqëri demokratike dhe paqësore. Kornizat e cilësisë janë mjete të rëndësishme për ta përmirësuar cilësinë e kopshteve, veçanërisht kur konceptimi dhe

vlerësimi i tyre kërkon pjesëmarrjen e edukatoreve dhe familjeve (Gariboldi, 2012).

d. Më shumë shërbime të integruara. Oferta e shërbimeve publike për fëmijët nga lindja deri në moshën 5 vjeçare (veçanërisht nga 0 deri në 3 vjeçare) mund të ofrojë tipologji të ndryshme të shërbimeve për fëmijët dhe familjet e tyre. Është e mundshme që të gjenden modele të ndryshme të shërbimeve në të gjithë Evropën: programi francez "Maison Verte" (Dolto, 1985, 2009), grupi anglez i lojërave, Qendra Italiane e Familjes (Mantovani) janë vetëm disa prej shembujve të shërbimeve, të cilat i mirëpresin fëmijët me familjet e tyre, duke përmirësuar përfshirjen sociale dhe edukimin e fëmijëve.

- Ngritja në profesionalizmin e edukatoreve nëpërmjet përmirësimit të trajnimit para-shërbimit dhe gjatë shërbimit.

Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se edukatoret e anketuara i perceptojnë me ndjenja të dyzuara ndryshimet ekonomike dhe shoqërore, të cilat janë duke ndodhur në sistemin edukativ të Kosovës. Nga njëra anë, ndiejnë se modelet edukative tradicionale nuk janë më të mjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave dhe sfidave të reja shoqërore, të cilat ofrohen nga kurrikulat e reja; nga ana tjetër, nuk e gjejnë në punën e tyre të përditshme, motivimin për të eksperimentuar me qasje të reja edukative dhe praktika të reja të mësimdhënies. Rezultat i këtij tensioni është rënia e kënaqësisë dhe motivimit në punë, veçanërisht për edukatoret më të moshuara. Në pajtim të plotë me rekomandimet e projektit CORE (Urban et al, 2011) për të avancuar profesionalizmin e edukatoreve të EKFH-së, është e nevojshme që:

a. Të rritet proporcioni i të diplomuarve (ISCED 5), veçanërisht për edukatoret e fëmijëve të moshës 0 deri në 3 vjeçare. Sfida do të mund të jetë, që të ketë në çdo klasë, së paku një anëtar të kualifikuar të stafit (ISCED 5).

Të ofrohet një Diplomë specifike në EZhFH (Edukim dhe Zhvillim në Fëmijërinë e Hershme), ose së paku një adresë për Nivelin Parashkollor, për trajnimin e edukatoreve të specializuara për fëmijët e moshës 0-3 vjeçare. Kjo diplomë do të duhet të përfshijë kurse për edukimin mbi nevoja të veçanta dhe edukimin ndërkulturor.

b. Të sigurohen marrëdhënie të barabarta dhe reciproke ndërmjet teorisë dhe praktikës. Për ta arritur këtë qëllim, do të jetë me rëndësi që të përmirësohen programet edukative (gjithashtu edhe trajnimet gjatë shërbimit), të cilat ofrohen nga universitetet në bashkëpunim të ngushtë me shkollat, për të garantuar ndërveprim reciprok midis teorisë dhe praktikës, si dhe për ta mbështetur reflektimin kritik (Schon, 1983).

c. Të zhvillohen kërkime cilësore (kualitative) për përfaqësimin dhe besimin e edukatoreve për ta mbështetur trajnimin (veçanërisht trajnimin gjatë shërbimit) për formimin edukativ të edukatoreve, si dhe për përvojën e jetës së tyre profesionale.

d. Të avancohet puna ekipore dhe bashkëpunimi ndërmjet edukatoreve, dhe ndërmjet edukatoreve dhe udhëheqësve pedagogjikë të shkollave. Gjithashtu, brenda kuadrit të një perspektive të vazhdimësisë me nivelet e shkollimit të obliguar (sipas ligjit Nr. 04/L-032 dhe mund të hyjë në fuqi që nga viti 2015-2016). Kjo do të jetë një çështje kyçe në të ardhmen (Moss, 2013). Në fakt, organizimi i sistemit edukativ/arsimor të Kosovës ofron një artikulim mjaft të fragmentarizuar të shkollimit: klasa për fëmijët nga lindja deri në tri vjeçare janë ende në pritje të një përkufizimi dhe kornize specifike; kopshtet janë reduktuar në dy vite, ndërsa një vit i detyrueshëm parashkollor është futur përpara hyrje në sistemin eduaktiv/arsimor fillor, që mund të hyjë në fuqi nga viti 2015/2016. Ky fragmentim duhet të zbatohet me anë të instrumenteve dhe mjeteve, të cilat garantojnë një vazhdimësi të caktuar të përvojës edukative të fëmijëve gjatë klasave të ndryshme, nga njëra te tjetra. Vazhdimësia bëhet mjet themelor për fëmijët me nevoja të veçanta, të cilëve iu nevojitet një projekt koherent dhe i individualizuar, i koordinuar me shërbimet sociale dhe shëndetësore.

e. Të zbatohet kurrikula duke marrë parasysh prejardhjen socio-kulturore të fëmijëve, si dhe kontekstin lokal. Kjo do të mund të përfaqësonte hapin e parë drejt realizimit në praktikë të pjesëmarrjes së prindërve dhe nxënësve në jetën shkollore, si dhe drejt hartimit të një procesi të vetë-monitorimit të cilësisë së ofertës edukative.

REFERENCAT:

BERTOLINI P. (1988), L'esistere pedagogico. Ragioni e limiti di una pedagogia come scienza fenomenologicamente fondata,, La Nuova Italia, Scandicci

COUNCIL OF EUROPEAN UNION, (2009A), Teacher Education for Inclusion.

COUNCIL OF EUROPEAN UNION, (2010). Joint progress report on the implementation of the Education and Training 2010 Work programme, http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:52010XG0506%2801%29

COUNCIL OF EUROPEAN UNION. (2008). Communication from the Commission 'Improving competences for the 21st century: an agenda for European cooperation on schools '

COUNCIL OF EUROPEAN UNION. (2009B). Council Conclusions on the professional development of teachers and school leaders.

EUROPEAN COMMISSION CHILDCARE NETWORK (1996) Quality Targets in Services for Young Children, Brussels.

GOLDSCHMIELD. E. (979) Il bambino nell'asilo nido : guida per le educatrici e i genitori. Fabbri. Milano.

ISSA (2010), Competent Educators on the 21st Century. Principles of Quality Pedagogy, Latvia.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, (2011) ligji nr. 04/L-032, Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, (2006) ligji nr. 02/L-52, Ligji mbi Edukimin Parashkollorë.

MANTOVANI, S., SAITTA. L., BOVE C., (2003). Attaccamento e inserimento. Stili e storie delle relazioni al nido. Franco Angeli. Milan.

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË. (2011), Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016.

MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË. (2013), Statistikat e Arsimit në Kosovë. Arsimi ParaUniversiratë.

MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY OF KOSOVO (2001). The New Kosovo Curriculum Framework.

MONTESSORI. M. (1991). La scoperta del bambino, Garzanti. Milano

MONTESSORI. M. (1999). La mente del bambino. Mente assorbente. Garzanti Milano. (Original fist edition in English, "The absorbent mind", 1949).

NESSE (2008). Early Childhood Education and Care: key lessons from researchers for policy makers, http://www.nesse.fr/nesse/activities/reports

OBERHEUMER, P. (2005) 'Conceptualizing the Early Childhood Pedagogue. Policy Approaches and Issues of Professionalism.' European Early Childhood Research Journal.

OECD (2001). Starting Strong I: Early Childhood Education an Care, Paris. OECD

OECD (2003) Reviews of National Policies for Education. South Eastern Europe, Vol. 1. Paris.

OECD (2006). Starting Strong II: Early Childhood Education an Care, Paris.

OECD (2008) Growing Unequal? Income Distribution and Poverty in OECD countries. Paris.

OECD (2012). Starting Strong III: A Quality Toolbox for Early Childhood Education an Care, Paris.

ONGARI, O., MOLINA P. (2002). Il mestiere di educatrice. Junior. Bergamo

SAVE THE CHILDREN (2007). Budget and legal analysis of Early Childhood Education in Kosovo.

UNICEF (2004). Situational Analysis of Education in Kosovo, Prishtina

UNICEF. (2001). Joined Hands. Better Chilhood, Yale University

USAID KOSSOVO. Early Chilhood Education: Opportunities and Constraints

WORLD BANK (2005). Reshaping The Future, Education and Postconflict reconstruction, Washington DC.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

373.2(048)
316-053.4(048)

Analiza e situatës mbi zhvillimin dhe kujdesin gjatë fëmijërisë së hershme / Franceska Emiliani...et al. - Prishtinë : Save the Children, 2014. – 96 f. : ilustr.; 30 cm.

Parathënie / Ahmet Kryeziu : f. 4. – Referencat : f. 80

1.Emiliani, Franceska 2. Balduzzi, Lucia 3. Melotti, Giannino 4. Villano, Paola

ISBN 978-9951-534-21-5

ISBN 978-9951-534-21-5